

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME NASER KUKËN

Prishtinë | Data: 30 shtator, 2022

Kohëzgjatja: 163 minuta

Të pranishëm:

- Naser Kuka (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotni Naser, nëse mundeni me u prezantu, ni hyrje për juve diçka, për prejardhjen e ju, familjen.

Naser Kuka: Unë jam Naser Kuka i lindun në prill të vitit '61 në Kaçanik nga nana Salihe dhe prindi Islam. Shkollën fillore dhe të mesme i kam kryer në vendlindje, ndërsa për shkollim të mëtutjeshëm gjatë vitit '81 më është bërë e pamundur nga pushteti i asaj kohe që mbante të pushtuar Kosovën dhe trevat e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi.

Anita Susuri: Në çfarë familje jeni rritë ju?

Naser Kuka: Familja ime ka qenë kryesisht familje punëtore, por arsimdashëse edhe atdhedashëse. Në atë familjen tonë, në shpijën tonë kanë hy e kanë dalë burra të trevave shqiptare nga Kosova edhe në vise të tjera shqiptare të Maqedonisë, në Maqedoni e ma gjanë. Normalisht që si te krejt te tjerët edhe te unë fryma familjare është bartë prej traditës të shpisë, prej themelit familjar. Aty janë, osht' mësu alfabeti i atdhedashurisë, i luftës për liri, i sakrificës kur kërkohet për interes të atdheut e tjera. Në këtë drejtim kam mësu shumë.

Kam mësu nga tregimet e prindit edhe të nënës time. Të cilët kanë pasë një moshë dhe kanë kalu periudha të rana nëpër të cilat ka kalu populli ynë. Gjatë pushtimeve të ndryshme edhe bullgare edhe si i kanë nda ata përpara, domethonë, Bullgari i Parë, Bullgari i Dytë, Serbia e Parë, domethonë ajo Mbretëri Serbo-Kroate-Slllovene, pastaj kjo pas Luftës së Dytë Botërore e tjerë. Domethonë, janë etapa historike të cilat i kanë përjetu vetë dhe në mënyra të ndryshme kanë qenë pjesë e tyre ose pjesëtarë e familjes tyre kanë qenë pjesë e atyne angazhimeve të asaj lufte që shqiptarët kanë zhvillu për atdheun e tyre, për çështjen e tyre madhore të kombit.

Anita Susuri: A ju kujtohet ni tregim konkret, për shembull diçka që kanë përjetu ose që kanë pasë shumë të vështirë?

Naser Kuka: Po më konkretisht më kujtohet, më kujtohet '56-ta. Viti 1956, aksioni i armëve, domethonë, aksioni që Jugosllavia e ka ndërmarrë në Kosovë për ç'armatosjen e shqiptarëve. Në këtë valë të arrestimeve është përfshi edhe prindi im, në këtë kohë. I cili osht' akuzu për ni arsenal, për ni sasi armësh të cilat kanë dalë nëpër njerëz të ndryshëm. Puna që pushtuesi, përveç mënyrave të presionit fizik e psiqik e persekutimit e vrasjes, ka përdorë edhe ni marifet tjetër, ni luftë tjetër duke i detyru njerëzit që me dorë në Kuran të betohen se s'kanë armë, se s'dijnë kush ka armë, e tjera.

Në këto raste ka pasë njerëz që kanë qenë të besueshëm edhe s'kanë mujtë me bo be rrejshëm edhe pse edhe feja e arsyeton, po se edhe kjo është ni lloj taktike, ni lloj strategjie që i shërben, në këtë rast, i ka shërby kauzës. Sidoqoftë, është ashtu, është arrestu, është malltretu po. Mirëpo, nuk i ka zgjatë shumë se ka arritë të ikë, ka arritë të ikë, t'i shpëton asaj që ka qenë e planifikume prej forcave policore të policisë Jugosllave në atë kohë.

Anita Susuri: Si ka arritë me e bo atë?

Naser Kuka: Ka dalë për dritare. Osht'... ka kërcy prej dritarës me ni moment kur nuk ka qenë kërkush brenda. Pastaj, ni furraxhi aty në qendër të qytetit e ka futë brenda në furrë. E ka mbajtë në depon e miellit disa ditë e ka strehu aty derisa janë kriju rrethanat për me dalë prej qytetit edhe me kalu në Stanat i thojna, në fshatin e tij ku ka ikë.

Anita Susuri: E deshta me ju pytë, diçka, kto aksionet për me i gjetë armët a kanë ndodhë vetëm në familje të caktume apo te të gjithë?

Naser Kuka: Jo, në këtë aksion është përfshi ni numër i madh i shqiptarëve. Po natyrisht ata kanë pasë lista, pushteti ka pasë lista të familjeve të cilat ka dashtë me i, me i, ose me i detyru në forma të ndryshme me u largu prej Kosove ose me, me futë, me futë atë psikozën e frikës përmes ktyne në popull. Ata nuk kanë punu pa ni projekt, pa ni strategji domethonë, dhe e kanë realizu atë strategji domethonë.

Unë e kom pasë ni dokument që ndoshta, domethonë, kom pasë ni dokument që kom lexu për këtë aksion, pikërisht për këtë aksion në regjionin e Ferizajit ku është përfshi edhe Kaçaniku e Shtërpca, domethonë ato rrethina. Aty përshkruhet, osht' dokument arkivor, ku përshkruhet në hollësi forma që osht' dashtë të aplikohet e dhunës te shqiptarët për t'i detyru për t'i dorëzu edhe ato pak armë që ju kishin shpëtu nëpër kohë, nëpër vite.

Unë në këtë kontekst do të thosha në '43-tën ni Batalion i Brigadës V-të Proletare të Shqipërisë ka qenë i vendosur diku mes Rakaj, Varoshit ni fshat aty, po. Nuk e di çfarë rrethanash, por gjyshi im me babën tim janë takuar me ta dhe e di që në pytjen e atij komandantit që ia ka shtu gjyshit se, "Çka po ua merr menja, si do të shkojnë puntë?" Ai osht' përgjegjë se, "Sa t'i kemi armtë në dorë edhe besimin në fitore e kemi". Kështu diçka, domethonë. Domethonë, sa i kanë pasë armtë në dorë kanë besu se vjen ni ditë

që, që ia kthejnë pushkën armikut për të realizu ato ideale shekullore të shqiptarëve për liri e bashkim kombëtar.

Anita Susuri: E në atë periudhën e Rankoviqit edhe pas Luftës së Dytë Botërore domethonë kjo, a ka qenë familja juaj si, si me thanë e përndjekur për naj arsye, apo qysh ka qenë pozita e familjes gjatë Luftës së Dytë Botërore?

Naser Kuka: Po, tashti, gjatë Luftës së Dytë Botërore kta kanë vazhdu jetën e malit, jeten e kaçakut edhe të rezistencës edhe të largimit, të ikjes mos me u bo pjesë e partizanëve të Titës. Domethonë, deri në këtë kohë ka qenë kështu për nga ana e babës. Ka ana e nanës, për shembull, kqyr se osht' interesant, ke dy kaçakë tërë jetën me pushkë në dorë, njëni vlla, domethonë dy vllazër. Tjetri osht' zanë në mal t'u i rujtë gjatë [bagëtitë] edhe e kanë zanë partizantë e kanë mobilizu me dhunë edhe osht' bo partizan, a po kupton.

Domethonë, mirëpo edhe, edhe, edhe kjo anë për shembull edhe ajo anë... se normal treva e Kaçanikut njihet si një trevë e cila i ka rezistitu pushtuesve nëpër shekuj edhe osht' pjesë e lavdisë të shënuar nëpër, në lëvizjen e rezistencës kombëtare e të luftës për ni Shqipni të vetme, të bashkume. Nuk osht'... ne natyrisht jemi rritë me histori të Idriz Seferit edhe të asaj lufte të zhvillume në Grykë të Kaçanikut, po pastaj osht' historia e Lëvizjes Kaçake, që gjithashtu ka lanë vija të pashlyeshme në kujtesën e popullatës të asaj treve e më gjerë.

Anita Susuri: Ju, domethonë, si fmi i keni dëgju gjithmonë kto biseda në familjen e juaj kanë qenë ndoshta edhe kjo nifarë forme iu ka, si me thanë, ju ka gdhend në personin që jeni bo ma tutje.

Naser Kuka: Apsolutisht, nuk diskutohet që kto biseda kanë qenë pothuajse të përditshme në familje. Por, pastaj, ni rol, ni rol të pazëvendësueshëm e kanë luftë edhe kangët e odave, melosi popullor, domethonë, të cilat në atë kohë kanë qarkullu dorë më dorë, domethonë. Po që kanë shërby në ngritjen e forcimin e vetëdijës kombëtare shqiptare. Domethonë, nuk janë nalë kto. Nuk e di si i gjente baba, ku i gjente, por ka pasë ni kasetofon ashtu, kanë qenë me shirita ato, ku di unë (qeshë). Po edhe ato lujnë rol se i këndohej Bajram Currit, i këndohej Hasan Prishtinës, i këndohej Skënderbeut, i këndohej Shaban Polluzhës, i këndohej atij e tjera. Kta nuk kanë mujtë me kalu pa lanë ni vijë në kujtesën e familjes edhe timën. Po te unë ka shërby pak ma shumë si fëmija, si djali ma i ri, ma i vogli në shpi, se prej pesë vllazërve, unë jom ma i riu. Po dhe në ni mënyrë kam qenë pak ma i afërt me prindin edhe me nanën.

Anita Susuri: A keni qenë vetëm djem? A keni pasë motra?

Naser Kuka: Po edhe ni motër e kemi, ajo osht' pak ma e re se unë.

Anita Susuri: Çfarë kujtime tjera keni prej fëminisë? Qysh ka funksionu familja ju? A ka qenë, domethonë, familje, po e themi që ka jetu në vlera patriarkale apo qysh ka qenë organizimi brenda familjes?

Naser Kuka: Organizimi brenda familjes, tashti, ne si, si histori familjare vijmë prej ni fshati në periferi të Kaçanikut, të qendrës urbane, Kukaj. Kukaj osht' fshati. Në '56-tën, pas asaj që fola pak ma herët, baba osht' shpërngulë prej fshatit me qëllim me ikë për Turqi. Po ka qenë e pamundur me i kompletu ato dokumentacionin që osht' kërku në atë kohë, se nuk e di çka osht' dashtë me nxjerrë në Shkup, ni lloj dokumenti, nuk më kujtohet tash. Vet nuk ka mujtë të shkoj e njerëzit që i ka çu për ta marrë atë dokument, për t'i kompletu dokumentet dhe për të shku në Turqi nuk kanë arritë me ia siguru dhe kështu që nuk ka shku, ka ngelë aty pastaj. Pastaj, janë kriju do rrethana pak ma lehtësuese, domethonë, dënimi i politikave të Rankoviqit, e tjera e tjera. Në ni mënyrë është stabilizu gjendja. Kosova, ato ndjekjet masive, kanë pushu. Dhe pastaj në këto situata e vendosin që me vazhdu me jetu në Kaçanik.

Anita Susuri: Ju shkollën fillore, sigurisht në Kaçanik e keni përfundu?

Naser Kuka: Po, po, po.

Anita Susuri: A ka qenë larg? A qysh ka qenë?

Naser Kuka: Jo, jo, afër. Na qendër urbane jam rritë. Edhe shkollën fillore edhe të mesme edhe qendrën e qytetit për dy minuta i kemi arritë. Por nanën e kom pasë analfabete, ama nana e ka udhëheq shpijen. Portofolin e shpisë e ka majtë nana, drejtimin e shpisë e ka bo nana. Për çdo gjë mrena shpisë, mrena oborrit është kujdesë nana. Ajo domethonë për shkollë, për shkollë ka qenë në gjendje çdo gja me bo, jo veç për mu, por për të gjithë të tjerët në familje.

Bile, se ajo mënyra patriarkale, nana jem ka shku në shkollë me kqyrë çfarë notash kanë djemtë e saj. Nuk e ka prit prindin, a po kupton? Se prindi ka qenë punëtor, ka punu punë, në hekurudhë ka punu. Po edhe pas orarit të punës ka punu privatisht, domethonë, sidomos kur kanë fillu kto ndjekjet ndaj meje, burgosjet, ai ka gjetë, ka gjetë edhe punë dytësore pas orarit të punës me punu, me siguru buxhet për me pasë mundësi me u kujdes për mu. Fillimisht për mu, pastaj edhe për bashkëshorten, e tjera. Pastaj edhe për veprimtari, se asnjë punë nuk bohet pa ni kosto.

Anita Susuri: E prindërit e tu çfarë gjenerate kanë qenë? Kur janë lindë ata?

Naser Kuka: Prindi osht' lindë në vitin 1918, nana me çertifikatë të lindjes është e 1924-tës, po duhet të jetë nja tri vite, sipas tregimeve që tregonte, duhet të jetë pak ma e moshuar.

Anita Susuri: Domethonë kanë qenë ni moshë kur ju kanë bo juve dikund ma...

Naser Kuka: Po tashti, baba, unë kur burgosem për t'u dënuar, që të dënohem, që të dalë para Gjykatës të Qarkut ktu në Prishtinë, prindi ka qenë penzioner, ka qenë në pension. Kur kam dalë prej burgut, nuk e kom gjetë në shpi për pak kohë. Ai domethonë është nda prej kësaj jete.

Anita Susuri: Po du me u kthy edhe pak te shkollimi, te fëmijëria domethonë aty, si ka vazhdu pastaj në Kaçanik? Qysh ka qenë qajo periudha pas Rankoviqit domethonë? Ju atëherë veç keni qenë fmi, a osht' vërejtë si ni periudhë ma e, nëse muj me thonë, ma e ndritshme për shqiptartë në Kosovë a qysh ka qenë?

Naser Kuka: Unë në kohën time mbaj mend, mbaj mend zhvillimet politike në Kaçanik në kohën e, vitet e '60-a, domethonë fundi i viteve të '60-a. Kryetarin e Komunës së Kaçanikut të asaj kohe ka qenë ni personalitet i madh e i respektueshëm dhe Kaçaniku e njeh si kryetar historik të Kaçanikut edhe sot. Ai në pozitën e kryetarit të Komunës së Kaçanikut ka ra në konflikt, ka kriju raporte konfliktuoze me politikën Titiste në Kosovë dhe e ka kundërshtu këtë politikë. Në pozita të kryetarit e ka përkrah demonstratat e vitit 1968 dhe kërkesat e tyre.

Pastaj, krijohen rrethana, rrethana të ni lëvizje, të vënies në lëvizje të popullatës në përkrahje të Sali Bajrës. Në ni mënyrë në '68-'69 Kaçaniku osht' vu në ni gjendje shtet-rrethimi. Për shkak se ato mbledhjet për shkarkimin e Sali Bajrës prej pozitës së kryetarit të komunës zgjatën gjithë natën, e gjithë ditën. Po kur vinte puna te votimet, nuk shkarkohej. Pastaj, me dekret të veçantë strukturat jugosllave e shkarkojnë prej asaj pozite.

Domethonë, Kaçaniku ka pasë edhe në këtë periudhë ni ngritje, ni ngritje të mirë të vetëdijes, vetëdijës kombëtare edhe me vet faktin se osht' rreshtu në krah të Sali Bajrës ka shpreh nivelin e vetëdijës edhe përcaktimin politik për çashtjen tonë. Une flas, në atë kuptimin për mu po edhe për pjesën dërmuese të Kaçanikut, Sali Bajra ka qenë ni figurë emblamatike, ka qenë ni simbol. Në ni mënyrë ka qenë edhe krenaria e brezit tonë. Por ai nuk ka qenë vet, ka pasë edhe të tjerë.

Pikërisht në saje të qëndrimit të tij në ato vite, domethonë diku rreth 70 intelektualë, aq sa ka pasë komuna e Kaçanikut janë largu prej partisë. Ata që kanë qenë në parti janë përjashtu, janë larg prej pune, janë ndërmarrë masa të ndryshme ndaj tyne, ndaj familjes së tyne edhe vet Sali Bajrës. Domethonë, largohet edhe disa vite, shumë vite kalon ni gjendje të randë edhe ekzistenciale. Por ka arritë me jetu e me gjallnu në saje të mbështetjes së popullit.

Këto gjëra, domethonë, këto çështje nuk, nuk dal asni milimetër prej kornizave reale. Mund të them se edhe kur i përcillnim për ushtri, që i çonin të detyrueshëm në ushtrinë jugosllave të ritë e Kaçanikut. Ne kemi dalë me i përcjellë në stacion të trenit, po gjatë përcjelljes së tyre kemi këndu kangë patriotike, atdhetare. Kryesisht kangë që këndoheshin atëherë [në ato] vite në Radio Tirana që ne i mësonim përmes valëve të Radio Tiranës. Domethonë, nuk e kemi pasë këtë gajle, kemi këndu

publikisht, jemi bo grup 20, 30, 50 vetë edhe kemi knu kangë patriotike të ndalume po që ne i kemi këndu publikisht.

Anita Susuri: E që përmendët Radio Tiranën, domethonë, sigurisht ju keni kapë frekuenca se keni qenë afër ndoshta, a ka qenë si me thanë, sigurisht se ka qenë e ndalume po qysh keni arritë ju me i kap këto frekuenca ose m'i dëgju këto?

Naser Kuka: Na herët kemi fillu, jo veç Radio Tiranën, Radio Kukësin, se edhe Radio Kukësi është dëgju dhe pothuajse 70 përqind të territorit të Kosovës është dëgju. Po edhe televizioni, Radio Televizioni Shqiptar. Kem pasë ni shok timin, shok imi i veprimeve, organizimeve të përbashkëta me profesion ka qenë elektrikist edhe ai bonte disa marifete me antena, ku e di se çka bonte, për me mujtë me hy në rrjetin e televizionit shqiptar. Ne i kemi përcjellë këto në Kaçanik, po normal kuptohet kemi pasë, kemi ditë që osht' ndonji film i mirë ose ndonjë dramë e mirë ose ndonjë kongres kur u mbajshin. Kongreset e partisë edhe ato kemi përcjellë e tjera.

Ndodh për herë të parë në histori të komunës së Kaçanikut, lejohet Ansambli Kukësi i Ri të shfaq ni koncert në Kaçanik. Për herë të parë, ka qenë hera e parë edhe e fundit deri në çlirimin e Kosovës. Ipet viza... kanë ardhë, në komuna tjera kanë ardhë, po në Kaçanik nuk e lejonin. Pastaj për shkak të pjesëmarrjes të madhe, prezencës të madhe të artdashësve të komunës së Kaçanikut, atë ditë koncerti u shfaq dy herë. Niherë paradite, niherë pasdite. Po pjesëmarrësit...

Edhe pse pushteti ish kujdes që biletat mos me u shitë, se nuk kanë qenë në shitje biletat, janë shpërnda në organizata të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë e tjera. Megjithatë ne e shoktë e tjerë që ishin të organizuar ose që ishin simpatizantë të Lidhjes së Rezistencës, përmes tyre arritëm me i nxjerrë ato, shumicën e biletave, dhe me i shpërnda nëpër shokë tonë në mënyrë që atmosfera me konë sa ma e mirë në sallë edhe me shprehë... domethonë nuk ishte pak punë kur dilke, ta zamë Bik Ndoja ose Liri Basha, e publiku me këndu bashkë me të.

Ata as s'e kanë marrë me mend që ajo pjesëmarrje e ato kangë që këndoheshin i dinë. Ose, për herë të parë u këndu, "O Kaçanik, e shkëmb e gur". Po bashkë me... se Shkodra ia falë Kaçanikut këtë kangë. Po edhe publiku e ka këndu barabartë me grupin që e këndonin këtë kangë. Grupi i Kukësit të Ri. Domethonë, Kaçaniku në ni mënyrë, nuk osht' tejkallim modestie, osht' thanë, osht' qujtë në anë tjera si ni Shqipëri e Vogël. Aty osht' marrë frymë pak ma lirisht, ndoshta edhe për shkak të afërsisë të njerëzve mes veti.

Kaçaniku në ni mënyrë është komunë familjare, domethonë se pjesa ma e madhe e familjeve janë të lidhun përmes lidhjeve të ndryshme njëna me tjetren. Ka pak të ardhun aty. Edhe për shkak të pozitës gjeografike edhe për shkak të, nuk osht' lakmu shumë ai si, si vend për me vërshu, me ardhë prej trevave tjera, prej anëve tjera. Kështu po them që s'ka qenë ndonji kështu vështirësi për me folë, për me zhvillu aktivitet se edhe të kanë njoftë edhe i ke njoftë të tjerët. Unë si i ri domethonë ndoshta edhe

nuk kom qenë në struktura të organizume ilegale, por libra kom lexu ilegale. Më kanë ra në dorë, shokë mas shoki. I kemi lexu, i kemi shpërnda. Ose revista, gazeta që atyne viteve qarkullonin në Lëvizjen Ilegale.

Anita Susuri: A ju kujtohet kur ka qenë hera e parë që ju keni kuptu që po ekzistojkan këto lidhjet që po shpërndajkan libra të ndalume ose...

Naser Kuka: Po, po, po, diku '70... në njëqind vjetorin e lidhjes, Njëqind Vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më kujtohet mirë, Odhise Paskali pat' hapë ni, ni, ni ekspozitë në Prishtinë. Unë erdha në atë ekspozitë, pastaj s'e di si erdhi puna me e bo ni hartim. Po gjithmonë nëpër hartime e ajo tema e parë osht' përcaktu, e dyta po ashtu e treta ka qenë e lirë me zgjedhë nxanësi. Si shumë herë në të kalumën edhe kësaj radhe e zgjedha të lirë dhe shkrova për ekspozitën e Odhise Paskalit, artistit të madh të popullit edhe për ato punime të tij që ai kish sjellë në atë kohë në Kosovë, por që pushteti nuk i la me u vendosë në ato vende për ku ishin destinu.

Pastaj, arsimtari që e ka lexu këtë hartim e ka marrë edhe e ka lexu klasë më klasë, a kupton? Unë e kom shok, ai është më i moshuar se unë por sa herë që rri, shihemi në qytet ma kujton edhe këtë rast. Domethonë, po kjo osht' periudhë 1968-ta, osht' periudhë e ngritjes të madhe. Pastaj, Njëqind Vjetori i Lidhjes së Prizrenit '78-ta ku aksionet e ilegales në Kosovë edhe trevat tjera shqiptare kanë qenë, kanë qenë mjaft të zëshme dhe pjesa ma e madhe e popullit nuk i kanë dorëzu ato, ato trakte që shpërndaheshin ato vite, i kanë mbajtur në shpi. Pastaj ia kanë dhanë dikujt tjetër me lexu. Ka qarkullu dorë më dorë. Kështu ka ndodhë edhe në Kaçanik, si në krejt komunat tjera të Kosovës.

Anita Susuri: Ju keni qenë në shkollë të mesme?

Naser Kuka: Po.

Anita Susuri: Keni qenë, ku keni qenë në shkollë të mesme?

Naser Kuka: Në Kaçanik.

Anita Susuri: Në Kaçanik.

Naser Kuka: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet kontakti i parë me dikënd që ka qenë në ilegale ose si e keni marrë vesh që ekziston?

Naser Kuka: Po tashti kjo me emra nuk ashtu, po mund ta ndërlidhi disi. Jo që asi, se unë kom ditë për, për njerëz që punojnë. Por ni kontakt më të afërt, ta zamë, 1980-tën erdhën veteranët e arsimit të

Shqipërisë që pas Luftës së Dytë Botërore kanë punu në shkolla të para pas lufte në Kosovë. Unë nuk më kujtohen rrethanat përmes të cilave arrita me kontakt me ta po pastaj u bona shok i tyne dhe bashkë me ta edhe në shoqëri me ta shkova në ato shkollën, “Emin Duraku”, e ku di unë që ata bonin vizitë edhe na në ni drekë, më duket ka qenë drekë.

Përfundimisht, aty nga afër pata rastin me nejtë edhe me folë me Beratin, Berat Luzhën që na ishim kaçanikas, na njiheshim. Po që aty kemi ndrru ma shumë llafe edhe për punë të çështjes shqiptare në ish-Jugosllavinë e tjera. Pastaj edhe njerëzit që ishin aty dhe gjëra tjera. Për shembull, unë, kemi pasë pastaj ni Gafurr Loku osht’ hero, osht’ vra gjatë luftës [1999] edhe ai si i burgosur i ‘68-ës, në Tetovë domethonë, demonstratat e Tetovës, demonstratat e flamurit. Edhe ai ka qenë ni adresë për shumicën e të rive të asaj kohe, se ka qenë i burgosur, i burgosuri politik e ka pasë ni emër. Domethonë, e ka pasë ni emër të respektueshëm në popull.

Po, po them prapë që adresë pas luftës, përveç tjerave, po pas Luftës së Dytë Botërore osht’ Lëvizja Kaçake, osht’ Sali Bajra dhe gjenerata e tij. Pastaj vjen gjenerata jonë, krijohet domethonë edhe pastaj deri në dalje në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Anita Susuri: E kto aktivitetet e para brenda organizatës, si janë shpërnda? Brenda juve domethonë, tre personat që keni qenë apo si kanë ardhë deri te ju krejt këto?

Naser Kuka: Në aspektin konkret të organizimit, ne fillojmë domethonë në ‘79-tën, ‘80-ën ne formum celula të organizume ilegale në sistemin e treshit, dy plus ni. Kështu ka shku. Jemi shtri edhe kemi siguru kanale të furnizimit me literaturë, me shtypin e kohës, domethonë shtypin ilegal të kohës që botohej kryesisht në emigracion atyre viteve pastaj edhe gazeta, revista që boheshin në, në Tiranë. Domethonë, këto ishin brumi se s’ke pasë ku merr diku tjetër.

Ne kemi pasë, kemi pasë, atë arsenal të literaturës agjitative, propagandistike që ka posedu lëvizja në Kosovë me të njejtën kemi posedu edhe ne. Ato kanë lëvizë, kanë qarkullu, nuk janë mbajtë në shpi. Po në rastin konkret, në Kaçanik, për vetën ose do të ndihesha ndonjëherë krenar për ndonjë punë në mesin e atyne punëve, e di vetën shumë krenar që me ato arrestimet e mia, me burgosjet e mia, me dënimet e mia nuk kam marrë shokë me vete asniherë. E them UDB-a nuk ka arritë me më thy asniherë, në asni rrethanë.

Tashti unë kam ra në burg ose herën e parë, për shembull, jom i dënum në atë procesin tonë gjyqësor, tre kaçanikas kemi qenë tret shokë. Pastaj të tjerët kanë qenë të rrethinave tjera. Po na jemi dënu tre po i kemi lonë edhe 30, a 50, 100 tjerë të organizuar që kanë vazhdu punën edhe pa neve. Domethonë, është arritë të ruhet substanca organizative në krejt rrethanat.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Brenda ktyne grupeve, grupit që keni qenë ju, cilat kanë qenë aktivitetet kryesore që keni bo? Cilat jeni angazhu?

Naser Kuka: Po aktivitetet kryesore kanë qenë leximi edhe shpërndarja e gazetave, e revistave ilegale, librave, e literaturës ilegale me të cilën kemi disponu atyre viteve. Normal kemi arritë të sigurojmë edhe në vija tjera, domethonë, e kemi pasuru arsenalin e materialeve që në atë kohë janë përdorë me qëllim të ngritjes së vetëdijes edhe të shtimit të rratheve organizative. Përcillja e rratheve organizative të bindur se ni ditë do të mbrijmë në ni fazë kur do të duhej ta kem popullin gati për luftë të armatosur. Na e kemi ditë që me letra nuk shlirohet Kosova (qeshë).

Por, është dashur të punohet në këtë drejtim për ngritjen e vetëdijes, për mobilizimin e masave, për shtimin e rratheve që të bohemi sa ma shumë. Në saje të ktyne punëve që janë bo në atë kohë për Kosovën edhe në vise shqiptare pavarësisht fuqisë së goditjes që Jugosllavia i ka dhanë lëvizjes ajo gjithmonë ka gjetë forca për ringjallje, për ecje përpara. Asniherë Jugosllavia nuk ka arritë me shpërba ose me ndërpre veprimtarinë atdhetare të Lëvizjes Çlirimtare në Kosovë edhe në viset shqiptare në ish Jugosllavi. Sado e fuqishme ka qenë goditja, përsëri ajo ka ekzistë, ajo ka vazhdu ma tutje me ecë dhe nuk osht' nalë deri në daljen publike të ushtrisë sonë të lavdishme.

Anita Susuri: Po kto gjatë, domethonë, gjatë kryerjes së aksioneve, a keni pasë rregulla për shembull ku keni me vepru ose periudha kohore brenda të cilave duhet me vepru?

Naser Kuka: Po, jo, ne... sistemi i ilegales ka shku kështu domethonë, niherë osht' përgatitë struktura e simpatizantëve dhe kur kjo punë osht' vlerësu se mund të shkohet më tutje me ni individ ose me ni grup shokësh atëherë ka kalu në antarësim të drejtpërdrejtë ku ka pasë ni disiplinë, ka pasë ni rregull po jo meniherë. Ka kalu ni periudhë, kanë kalu tre muj a gjashtë muj a ndoshta edhe ma shumë. Ose ka raste që, domethonë, gjithë jetën e ke lonë në pozitën e simpatizantit po ai ka bo ma shumë se ti {bën me duar nga vetja} punë, a po më kupton?

Anita Susuri: Ajo u konë si ni periudhë e, si testim ndoshta për atë person?

Naser Kuka: Po, periudha, kur ia ke dhanë ti dikujt ni libër me lexu në qoftëse e ka pranë ai ka qenë hapi i parë. Pastaj, në qoftëse e ka përcjellë ma tutje osht' hedhë hapi i dytë e tjera. Domethonë, kanë qenë disa rregulla të organizimit edhe të shkruara edhe të pa shkruara. Po na ka shërby shumë normal se populli asniherë s'e ka pranë dhe nuk osht' pajtu me pozitën e popullit të pushtum. Na kanë hy në punë edhe përvojat e brezave para nesh.

Anita Susuri: Dashta me u ndërlidhë me kta që thashë edhe periudha si testimi, cili ka qenë momenti që i është besu dikujt që mund të jetë pjesë e grupit?

Naser Kuka: Po tashti...

Anita Susuri: Ose ka qenë për secilin e veçantë, varet?

Naser Kuka: Tashti, tashti, ta zamë unë kur e kom thirrë i kom bo ftesë dikujt për t'u bo pjesë e Lëvizjes i kom tregu se unë jom ktu, "Unë jom ktu, a po vjen me mu? A je i gatshëm me hy në ni rrugë e cila mund të sjellë pasoja në jetën tonë po përmes të cilës e kemi të domosdoshme me ecë". Kështu ka shku domethonë, osht' fitu besimi, e kemi shqyrtu, kur e kemi bo vet e kemi... po prapë, ni strukturë edhe dikush tjetër osht' dashtë me ditë këtë punë. Me raste kur ka qenë e paevitueshme se na kemi punu në sistemin me pseudonime domethonë.

Kështu osht' vendosë, osht' kriju bindja se "X" personi i plotëson të gjitha kushtet edhe të sjelljes në përditshmëri edhe të ngritjes edhe të përkushtimit edhe të gatishmërisë të tjera për me, me u bo pjesë e lëvizjes. Dhe kur osht' ardhë në këtë përfundim, i plotëson të gjitha kushtet për me qenë pjesë e jona atëherë ia kemi thanë, "Tregoj". Pastaj ia kemi thanë betimin, e ka dhanë betimin e tjera e tjera. Domethonë, se sado që ka zgjatë kjo puna e testimi ka ardhë ni moment që me i thanë. "Unë jom ktu, a po vjen edhe ti?"

Anita Susuri: E ky betimi që po thoni, se shpesh e përmendin, a kanë qenë, fjaltë që janë përdorë a i dini ndoshta? Edhe a janë domethonë të lira tash për publikun me i ditë të gjithë?

Naser Kuka: Po dihen këto. Janë botu me dhjetra libra e punime të ndryshme domethonë, po esenca osht' kjo që do të punoj deri në pikën e fundit të gjakut për realizimin e aspiratave tona kombëtare. Esenca e betimit osht' ky, domethonë. Siç ka qenë edhe betimi ushtarak i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Tash nëpër kohë, në rrethana ka ndryshu, ka ndryshu strategjia e punës ose realitetet janë zhvillu ndryshe nga ajo për të cilën ke punu po nuk osht' varë edhe nuk varet ni proces historik i ni populli veç prej disponimit të brendshëm të tij. Sidomos për ne kur je problem i tavolinave të kancelarive botënore. Domethonë, që na sa herë kemi propagandu, kemi luftu, jemi angazhu për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, po tashti procesi ynë nuk osht' përmbyllë. Del ni brez tjetër e çon edhe atë amanet në vend.

Anita Susuri: Po du tash me folë për periudhën kur keni vazhdu fakultetin, a jeni ardhë në Prishtinë?

Naser Kuka: Jo, s'jom ardhë se mu m'u mirret e drejta e shkollimit në universitet...

Anita Susuri: Kjo ka qenë domethonë në '82-tën, po para...

Naser Kuka: Jo, '81-tën më mirret e drejta e shkollimit.

Anita Susuri: A mundeni për qita me tregu? Ka qenë në kohën kur janë zhvillu demonstratat?

Naser Kuka: Jo, ndërlidhet tashti. Vendimi osht' marrë në atë kohë, vendimi osht' marrë në atë kohë po me 28 janar, 1981 unë me ni grup shokësh i kemi bo ni vizitë Shqipërisë. Pastaj, ktu filloi ajo, me ni mënyrë, tashti kishin dalë në... se ka mjaftu veç me shku në Shqipni, me shku, për pikë qefi me shku po ke shku në Shqipni po ke hy në listën e atyne njerëzve që duhet me u përcjellë, duhet me u majtë në vëzhgim e tjera.

Anita Susuri: Në Shqipni keni shku në mënyrë legale apo ilegal?

Naser Kuka: Jo, jo legale kemi shku. Tashti, sipas Sigurimit jugosllav, politikave jugosllave ajo osht' vlerësu vizitë ilegale, se ata domethonë paskan qenë do rregulla që në fakt as s'i kom ditë. Që përveç vizës të Ambasadës së Shqipërisë në Beograd, atë listë sipas tyre qenka pasë dashtë me përcjellë edhe në organe të tjera të LKJ-së a sigurimit, ku di unë. Për me marrë vizën edhe prej tyre që ban me shku ose s'ban me shku ose do ban e do s'ban. Me ta fut' edhe naj element të tyre në strukturën e tjera e kshtu qysh kanë punu. Ne nuk e kemi respektu këtë normë. Unë personalisht as s'e kam ditë, po edhe me pasë ditë përsëri s'e kisha respektu.

Anita Susuri: Domethonë, ju keni kërku vetëm lejen prej Shqipërisë?

Naser Kuka: Po, po. Kemi marrë lejen prej Ambasadës së Shqipërisë. Këtë procedurë normalisht unë e kam drejtu, unë e kom udhëheq. Dhe pastaj pas kthimit, normal jemi përballë edhe me probleme jo të vogla. Në qoftëse na ma herët isha marrë në biseda informative pse po rri me armikun e Jugosllavisë, Sali Bajrën. Tash fillunë me u marrë me mu ose fillunë me marrë të tjerë, "Pse po rrin me Naser Kukën?" E tjera.

Anita Susuri: Para se me vazhdu te kjo, po më intereson shumë se kjo pjesa kur keni udhëtu në Shqipëri se ni numër shumë i vogël i njerëzve kanë shku në atë kohë. Qysh ka qenë krejt ky përjetimi i juj? Edhe pse keni shku nëse bon me ditë?

Naser Kuka: Tashti brezi ynë secili, rinia osht' ajo pjesa e jetës ku, e cila nuk sheh pengesa në rrugën që don me ecë, nuk ka fuqi në botë që mund ta ndalë në rrugën për të cilën është nisë. Ne i takojmë këtij brezi dhe jemi pjesë e saj. Po jo veç për këtë punë, po për secilën punë. Në qoftëse don me bo e bon. Edhe ne kemi dashtë me bo, kemi marrë përgjegjësi në atë kohë për këtë çashtje. Me pa ma afër, me pa naj mundësi që edhe na shërben për knej. Ato që i kemi menu i kemi realizu, domethonë.

Ana e jashtme nuk më ka lanë, mu personalisht nuk më ka lanë përshtypje. Unë as nuk e di, se kur u kthym na pyesnin, a kishin ashtu, a kishin kështu. Po unë s'i kom vu mendjen me çfarë shporeti e ka pjekë bukën, a më kupton? Ose çka ka pasë shtrojë. S'kom shku me atë ngarkesë. Kom shku, qysh shkohet, qysh shkon njeri në shpi të vet, qysh shkon njeri në atdhe të vet, qysh shkon njeri në vendin të cilin e ki andërr, e ke pasë andërr, se ishte e ndaluar.

Anita Susuri: Sa keni qëndru atëherë?

Naser Kuka: Saktësisht nuk më kujtohet, po dy javë të mira po. Edhe pse kemi pasë leje edhe kështu po edhe atje na kanë thanë, “Rrini sa të doni, shkoni ku të doni”. Në fund ne kishim marrë në shumë, secili prej nesh, ishim marrë vesh ka sa para me i pasë me veti secili. Por, megjithatë, ata na thojshin, “Hajt në fund i boni pagesat, në fund i boni pagesat”. E në fund s’na lanë me bo pagesa. Domethonë, nuk kemi pagu gja.

Anita Susuri: Keni qëndru te dikush, ndonjë mik apo ka pasë hotele?

Naser Kuka: Jo, jo, në hotele na kanë vendosë, se vizita ka qenë e organizume. Po, po, nuk kemi pasë pengesa. Në qoftëse kemi shpreh dëshirën me shku dikund kemi shku. Na kanë çu, e kanë siguru infrastrukturën e udhëtimit e tjera edhe na kanë çu. Nuk osht’ bo naj vizitë pa u konsultu me neve, pa thanë ne po shkojmë aty ose aty, po e kemi pasë dikënd që na ka shoqëru prej aty. Ata i kanë thanë në atë kohë turizëm, domethonë, ai sektori, turizëm.

Anita Susuri: Ju keni vizitu vendet që janë monumentale në Shqipëri apo keni shku me qëllim me kriju marrëdhënie, lidhje, ndoshta?

Naser Kuka: Çka kemi dashtë me bo, kemi bo. Ku kemi dashtë me shku, kemi shku. S’na ka mbetë diçka marak që valla s’mujtëm me bo këtë punë. Çka kemi dashtë kemi bo, me kond kemi dashtë me u taku jemi taku. Po kemi dashtë edhe me fjetë me në shpi private të lidhjeve familjare, lidhje mas lidhje, edhe kta e kemi bo. Kemi qenë të lirë vlla si në shpi, si në shpi të vet njeri.

Anita Susuri: A keni qenë grup i madh kur keni shku?

Naser Kuka: Nantë persona kemi qenë, nantë shokë.

Anita Susuri: Thatë që kur jeni kthi keni pasë probleme...

Naser Kuka: Ka pasë, ka pasë probleme. Ka pasë probleme, po i kalum këto, po u ndërlihd ashtu puna. Po pastaj erdh 11 marsi [1981], s’kishin kohë me u marrë ma këtë punë, se lypshin ma shumë e tjera. Ajo, ajo fusha e hetimeve gjatë arrestimit ose ftesat për bisedë informative zgjerohej vazhdimisht se tashti pak ndërlihdhej edhe koha kur ne kishim shku në Shqipëri me ngjarje pranverore, a po më kupton? Dhe kjo e vështirësonte pak problemin tonë. Po ‘81-tën e kemi kalu, ka pasë probleme. Jemi marrë [në pyetje], jemi malltretu, jemi ashtu, jemi kështu. Por, megjithatë e përmbyllëm ‘81-tën mirë dhe hynëm në vitin ‘82 kur kishim fillu me mendu për përvjetorin e, organizimin e përvjetorit të demonstratave të ‘81-tës.

Anita Susuri: Po du pak me u nalë te '81-ta se keni qenë pjesëmarrës i demonstratës. Unë mendoj që ia vlen me dokumentu ajo çka ju keni pa. Po fillimisht a e keni ditë ju që po organizohet diçka?

Naser Kuka: Po na kemi punu me organizu, kemi punu me kriju rrethana e organizimit publik, e kundërshtimit publik të Jugosllavisë, kundërshtimit popullor. Ky ka qenë qëllimi. Po megjithatë 11 marsi, 11 marsi personalisht mu nuk më ka befasu, po unë nuk e kom ditë që ka me ndodhë 11 marsi. Nuk mund të them që e kam ditë, se s'e kam ditë.

Anita Susuri: Nuk e keni ditë sakt ditën?

Naser Kuka: Jo, jo, s'mund të them atë. Atë e kom marrë vesh të nesërmen këtë punë që shpërtheu. Kjo na gëzoi shumë, na boni për... se ishim të vetëdijshëm se me randësi është me fillu procesi se kur fillon ma s'nalet.

Anita Susuri: 11 marsi faktikisht ka qenë si gaca e parë, po pastaj ka vazhdu edhe me marrjen e shtafetës edhe 1, 2 prilli që po më duket ka pasë ma shumë dhunë.

Naser Kuka: Ka fillu me 20 prill, ka vazhdu me 26 mars, 1 prill, 2 prill, 3 prill. Me 3 prill osht' vendosë gjendja e shtetrrëhimit në Prishtinë. Kanë ardhë forca speciale të policisë të Jugosllavisë edhe ka pasë në periferi, domethonë edhe me 3-tin [prill] ka pasë rrugëve periferike. Po jo sikur me të 1 edhe me 2 [prill] kur krejt Prishtina ishte në kamë.

Anita Susuri: Ku keni qenë ju në ato momente edhe çka keni pa? Çka keni përjetu?

Naser Kuka: Unë me 11 mars nuk kam qenë. Unë e di që osht' zhvillu prej shokëve, po unë nuk jom pjesëmarrës i 11 marsit. Bashkëshortja ime osht' pjesëmarrëse.

Anita Susuri: E me 1, 2 prill?

Naser Kuka: Kam qenë me 1 prill, me 2 prill edhe me 3 prill deri kah mesdita. Pastaj, jemi, domethonë, ishte e pamundur me lëvizë prej Prishtinës me autobus a... po veturë s'kemi pasë na në atë kohë, po jemi nisë në kambë. E kishim në dijeni se diku rreth orës 2:00 pasdite fillon demonstrata në Ferizaj dhe donim edhe aty të jem pjesë e saj. Kjo ishte shkak që na i nisëm në kamë me shku në Ferizaj. Pastaj, jemi pjesë e... normal, ne kemi punu për shtrirjen e frymës së demonstratave në Prishtinë. Në qoftëse asgjë tjetër s'kemi bo bile gazlotsjellës, domethonë, kemi thithë boll atë ditë (qeshë)

Anita Susuri: E ju thatë që pas kësaj prapë ka pasë, kanë ardhë ju kanë marrë në pyetje, ju kanë malltretu për shkak se e kanë lidhë me shkuarjen e juaj në Shqipëri...

Naser Kuka: Po ka ndodhë, po, po, po.

Anita Susuri: Po vazhdu të '82-ta, viti kur ju jeni burgosë.

Naser Kuka: Unë jom burgosë me 5 ose 6 mars '82 nën akuzën për veprimtari të organizuar armiqësore nacionaliste, separatiste, irredentiste të paraparë, domethonë, me Nenin 136, lidhur me Nenin 114 të Kodit Penal të Jugosllavisë në atë kohë. Me këtë akuzë jam arrestu dhe jam burgosë.

Anita Susuri: Zoti Naser, thatë që hera e parë burgosja, po mendoj, nuk osht' hera e parë po që ju kanë mbajtur gjatë, ka qenë me 5 ose 6 mars të vitit '82 kur edhe jeni dënu me burgim...

Naser Kuka: Po.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë krejt kjo? Si kanë ardhë ju kanë marrë? Pse?

Naser Kuka: Në fakt, në ditë para se të arrestohesha unë, tashti kjo ka ndodhë me datë 5 mars apo me 6 mars, nuk jom krejt i sigurtë. Po në ditë, domethonë, brenda ktyre dy ditëve osht' arrestu ni shok imi, bashkëveprimtar i imi, shok ndër ma të afërmit që unë kisha atyre viteve në organizimeve ilegale edhe ma vonë pastaj. Për mungesën e tij në shpi gjatë natës unë jam informu prej ni motrës së saj, së tij. Domethonë, s'ka ardhë gjithë natën, "A din ku osht'? Ku ka shku?" E kështu.

Unë dija diçka që ka shku dikund, po ai ishte kthy diku në kohë të darkës. Por edhe e ka marrë [informatën], osht' njoftu prej familjarëve të vet që dikushi po e kërkon. E gjatë ditës kanë shku shpesh në shpi me u interesu a ka ardhë, e kur vjen, e tjera. Të njejtit kanë kërku që me i sjellë, se mu s'ma kanë ditë shpinë, me i sjellë te unë. Por, meqë kanë lanë pak dyshime në sjelljet e tyre, ata nuk kanë pranë me i sjellë te unë.

Tashti kur më tha që s'ka ardhë gjithë natën, 99 përqind ma mori mendja se duhet të jetë arrestuar. Megjithëse, nuk isha krejt i sigurtë. Kur dola në qytet, domethonë, kjo ka ndodhë të enjten, të premten ditë tregu në Kaçanik dhe zakonisht e mirrja shtypin kur dilsha prej shpisë. Shoh ftyra të panjohura që...

Anita Susuri: Që po sillen përreth.

Naser Kuka: Që po sillen kështu. Tashti normal i mora masat që duhej t'i merrja për çdo eventualitet mos me gjetë gja në shpi dhe tjetra nëse qëndron që ai shoku është arrestuar atëherë dija që edhe unë arrestohem. Për shkak të afërsisë, e punëve të përbashkëta që kishim. I mora këto masa, ndërmorra disa veprime për t'i lanë lidhjet e celulave edhe porositë e vazhdimet të punës, pavarësisht çka ndodhë sot ose nesër dhe shkova në shpi dikur pasdite për t'u sjellë pak, për t'i pa edhe niherë familjen, se ta them të vërtetën nuk doja që në prezencë të familjes me më arrestu.

Kisha mundësi të largohem po nuk, nuk doja të largohem se nëse e kanë mbyllë atë shokun, ni shok timin, bëhet fjalë për Hysen Shehun, atëherë edhe mu le të më mbyllin. Domethonë, kështu ishte. Tashti, domethonë, brenda ditës vinte dikush prej familjarëve të tij me më lajmëru, “Ka diçka të re? S’ka diçka të re? Ka lëvizje të dyshimta rreth shtëpisë?” E tjera. Dikur vonë u binda që ai osht’ arrestu. Por që kanë ndodhë edhe arrestime tjera edhe në anë të ndryshme të Kosovës, unë nuk e kam ditë se në atë kohë nuk kemi pasë edhe mundësi të komunikimit kështu, siç i kemi tash telefonat ashtu.

Dikur vonë, besoj ka qenë tetë, nantë në mramje jom arrestu edhe unë. Kam qenë në ni tryezë me shokë, në mesin e tyre Sali Bajra. Ishin angazhu forca të mëdha policore të njësisë speciale të policisë. Ish rrethu ai vendi, objekti ku kemi qenë ne dhe në ni moment, domethonë më kanë, kështu më kanë kidnapu e tjera. Ta tham të drejtën kur më sollën në Qendrën e Sigurimit Shtetëror në Ferizaj u lirova. Se e mora vesh që Hyseni qenka në burg dhe ai në burg edhe unë në burg. Dhe tashti s’ka gja tjetër përveçse me qëndru në mënyrë që burgosja jonë mos me shkaktu pasoja në proceset që ishin nisë.

Pastaj dikur gjatë hetimeve u mor vesh që ka edhe të tjerë që janë arrestu të Ferizajit, të Vitisë, të rrethinave e tjera. Ne arritëm me e përmbyllë këtë proces hetimor pa ndonjë pasojë tjetër. Sidomos në rathët e organizimeve. Domethonë na kanë marrë ne, ne kemi ngelë brenda, u përmbyll procesi, na nxorën para gjyqit, na dënuan dhe...

Anita Susuri: Sa ju kanë dënu?

Naser Kuka: Po në këtë proces, unë jam dënu katër vite burg. Ky shoku im për të cilin fola osht’ dënu tri vite e gjysmë dhe të tjerët janë dënu me dënime tre vjet e ma pak. Kështu ka qenë, domethonë.

Anita Susuri: Ku e keni vujtë dënimin? Në cilin burg?

Naser Kuka: Janë disa burgje hetuese në Kosovë. Fillimisht në Ferizaj, pastaj në Prishtinë, në Burgun e Qarkut të Prishtinës. Prej aty në Burgun e Mitrovicës dhe pastaj në Sarajevë disa muaj edhe prej Sarajevës më transferojnë në Burgun e Zenicës. Prej Zenicës kam dalë prej burgut në mars të ‘86-tës. Burgun e kam mbajtur ditë më ditë, sa kam qenë i dënuar. Nuk ka qenë ni jetë e lehtë, jeta e burgut sikurse për krejt tjerët. Po...

Anita Susuri: Si kanë qenë këto burgje? Për shembull, Burgu i Prishtinës?

Naser Kuka: Po tashti, ta zamë, disa ditë ose ma shumë se ni javë jam mbajtur në... jam arrestu në podrumet e Qendrës së Sigurimit në Ferizaj. Aty ka qenë ma rondë se s’ke pasë bukë, e s’ke pasë ujë dhe hetimet kanë zgjatë, domethonë, ditë e natë. Ata, grupet hetimore janë ndrru mes vete, po krejt ata janë marrë me ty. Normalisht, domethonë nuk ka qenë e lehtë, ka qenë e vështirë. Pastaj, në burgun, prej dallim prej podrumit ishte pak më ndryshe. Burgjet nuk dallojnë mes vete, burgjet janë burgje, domethonë mund të dallojnë njerëzit, mund të dallon hapësira. Ni qeli ma e vogël, ni qeli ma e

madhe, por ai është burg. Në Prishtinë hala s'kam shku me vizitu që osht' bo kështu [e hapur për vizitorë]. Boll kam ndejtë aty, nuk kom ndonjë merak me e pa.

Ka qenë pak ma specifike puna që banjot kanë qenë, domethonë pastrimi ka qenë jashtë objektit. Osht' dashtë me dalë, përmes asaj shëtitorës që ne i thonim atëherë, ni lloj lame, lame ku u dashke me u sillë aty dy-tre minuta sa na lejonin në shëti, në ajrosje. Pastaj, banjot kanë qenë brenda shëtitorës domethonë. Osht' dashtë me dalë në dimër, në ftoft, e në shi ku di unë, me kalu përmes shëtitorës me shku me u pastru që kryesisht në të shumtën e rasteve nuk ka pasë ujë të ngrohtë. Është dashtë, domethonë me ujë të ftoftë edhe nuk më kujtohet saktësisht a ka qenë niherë në javtë, a dy herë në javtë pastrimi. Po kjo ka qenë për secilin edhe nuk ka pasë përjashtime. Në Prishtinë kështu ka qenë.

Në Mitrovicë pastaj ka qenë hala edhe ma vështirë. Ka qenë ma vështirë për neve që ishim brenda. Më vështirë po ashtu ka qenë për familjarët që vinin në vizita, se ka ekzistuar ni rregull tjetër, ni përcjellje tjetër e bisedave, ni sjellje ma e rreptë, më e keqe ndaj familjarëve që kanë ardhë për të na vizitu dhe vizita ka zgjatë zakonisht dy minuta, tre minuta një herë në 15 ditë në burgjet hetuese të Kosovës. Në Sarajevë e në Zenicë ka qenë në çdo muaj, ni vizitë çdo muaj.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për këto ndërrimet që ju kanë bo të burgjeve. A keni qenë ju të informuar për këto që keni me e ndrru burgun edhe qysh ka ardhë ai informacion deri te familja? A e ka ditë familja?

Naser Kuka: Du ta them, jo, njoftime nuk ka pasë. Ka hy gardieni e ka hapë derën, "Dil jashtë!" E ka thirrë atë që e ka thirrë. Për shembull, kur më ka thirrë mu, "Dil jashtë!" Ke dalë jashtë, ata tjetër kanë pritë në anën tjetër. Ka hy gardieni ka thanë, "Gjërat e..." atij që e kanë nxjerrë jashtë, "nxirrni jashtë". Dhe s'kanë dhanë mundësi as me u përshëndetë me shoktë e qelisë që i ke pasë kur ke qenë me shokë. Kur ke qenë vet... jo s'e ke ditë, as s'e ke ditë se ku ki me shku.

Kjo, për shembull, ta zamë, po kjo ka të bëjë pastaj me ni fazë tjetër. Po, prej Mitrovicës transferohem në Sarajevë e nana ime nuk e ka ditë ose familja ime nuk e ka ditë që unë jam në Sarajevë. Kta kanë shku te gjykatësi përkatës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për me marrë leje për vizitë, se në çdo vizitë është dashtë me marrë leje. Kur kanë shku për këtë kohë që po flas pas transferimit tim në burgun e Sarajevës, ata nuk i kanë thanë që nuk osht' në Mitrovicë e shkoni në Sarajevë se atje e kemi dërgu. Domethonë, familja më ka kërku nëpër burgje tjera ku ia ka marrë mendja se mund t'jem ni kohë të gjatë. Derisa në rastësi më anë gjetë në burgun e Sarajevës, kanë shku me pytë, "A osht' ktu?"

Anita Susuri: Deri në Sarajevë kanë shku?

Naser Kuka: Po. Po i kanë shëtitë edhe burgjet e tjera. Po pastaj edhe ktu ka pasë probleme, ka pasë probleme se nuk lejonin me folë shqip. Ka pasë kufizime më të randa, se në burgje të tjera të Kosovës. Ka mungu ajrosja, ajo shëtitë. Ni minut, ni minut, po ke dalë jashtë, që nënkupton se përveç asaj që shumë larg, larg shpisë, larg Kosovës edhe edhe vështirësive që janë imponu për vizita edhe kur ka ndodhë vizita ka pasë probleme se osht' dashtë me pritë me orë të tëra. Që ta zamë vizitën e parë me nanën e kom realizu larg-a-larg, domethonë, larg-a-larg se u morëm vesh, domethonë, që serbisht nuk flasim, nuk dojmë me folë. Po, s'paku nana me u bind që jom gjallë që me më pa prej ni distance.

Anita Susuri: E burgu i Sarajevës po më duket që ka qenë burg kështu me kate shumë?

Naser Kuka: Unë nuk e kom pa nga jashtë, nuk e di. Po ka qenë sa kom mësu pastaj në burg të Zanicës, burg i kohës së Austro-hungarezëve. Nisoj qysh ka qenë burg i Austro-hungarezëve edhe Burgu i Qarkut të Mitrovicës. Po ka qenë projekt i tyne, se kjo është ndërtu pas Luftës së Dytë Botnore. Po ai ka qenë burg i vjetër, se tregojshin tjetër që kanë qenë, se ato në Zenicë, kryesisht kanë qenë boshnjakë domethonë. Ka pasë edhe të burgosur politikë kroatë, po prej tyne çka kam dëgju për atë burg, ka qenë burg i vjetër i kohës së Austro-hungarezëve.

Anita Susuri: E në burg ju, për shembull, ju të burgosurit politikë a keni pasë kontakt me njoni-tjetrin? A keni mujtë me folë apo?

Naser Kuka: Jo, në burgje hetuese jo. Jo që s'kemi folë, po kohën ma të gjatë nuk osht' leju as shtypi. Neve na është dashtë me bo greva të shumta edhe për, edhe për fitimin e të drejtës së librit, të botimit të librit. Me pasë të drejtë familja me na sjellë ni libër, me na u dhanë gazeta me pagesën tonë. Ka pasë rrethana, domethonë, kur osht' leju shtypi por edhe nëse osht' leju varësisht prej situatës jashtë. Në qoftëse ka pasë lëvizje jashtë, në qoftëse ka pasë procese jashtë, në qoftëse kanë bo protesta jashtë ose ta zamë në kohën e helmimeve që ndodhën në Kosovë '88-ën. '88-ën a ishin? A '89-ën? Atëherë nuk ipej shtypi. Pastaj, kur kemi ra në burg në fillim të fillimit edhe buka ka qenë e kufizime. As bukë s'ke pasë mjaftueshëm. Bukë, s'po flas për tjerat, po për bukë.

Anita Susuri: Deshta me folë edhe për grevat që po i përmendni, cilat kanë qenë grevat ma të gjata që i keni mbajtur edhe për çfarë arsye i keni mbajtur? A ka qenë për libra? Për këto materiale apo për diçka tjetër?

Naser Kuka: Grevën do ta përmendi, grevë. Kemi bo shpesh greva, për shembull, kemi bo grevë për që policët e burgut mos me pasë të drejtë me bajtë pendrek në koridore të të burgosurve. Me mbajtur në trup, me mbajtur me vete. Po, ta zamë në burg të Mitrovicës ka qenë e detyrueshme me i mbajtur durë mrapa edhe me i pa hapat ka ecë për tokë, mos me ngritë kokën lart. Edhe mos me folë, edhe me ata që i ke pasë në dhomë mos me folë. Nuk e di si erdhi dhe u morëm vesh qashtu që durë s'kemi me i mbajtur mrapa edhe kemi me folë në shëtitore.

Në kit' kohë ishim në ni qeli të përbashkët me Ukshin Hotin edhe Ferat Mujën. Ky Ferati ka qenë për vepër tjetër, po politika e ka dënu me vdekje me motive nacionaliste e tjera e tjera. Ka qenë domethonë i dënuar për vrasjen e ni sërbit. Vrasje e domosdoshme në vetëmbrojtje, vetëmbrojtje. Mirë, në këtë rast, domethonë ai gardieni që rrinte në atë farë, atë farë, s'po di si t'i them, ka qenë ni trafikë...

Anita Susuri: Karaulle?

Naser Kuka: Po. Edhe tha, "Mos folni, kokën poshtë e durte mrapa". Ukshini tha, "Durtë nuk i mbajmë mrapa edhe kokën s'e mbajmë ulur", tha, "Veç tashti apo për sa herë e keni vendosë?" "Përgjithmonë", tha, "nuk jemi", tha, "ktu në kishë e në xhami me u sjellë e me u lutë për faljen e mëkateve që kemi bo", kështu diqysh. Ai e tha mirë Ukshini, në mënyrë filozofike për merak. Na ndërprejtjen shëtitjen, na kthynë në dhomë edhe pastaj disa ditë nuk na nxorën fare në shëti.

Na vendosën në mbikqyrje mos me pasë mundësinë të komunikimit me dhoma tjera. Komunikimit, domethonë, përmes murit që me e shtri këtë ndërmarrje të refuzimit për mbajtjen e durve mrapa dhe kokën ulë. Pastaj, mirë patëm mundësi me përcjellë te dhoma fqinje bisedë për muri, se të burgosurit gjejnë mënyra për me komunikue mes vete. Edhe pastaj u shtri kjo u zgjeru në krejt burgun dhe e fitum këtë edhe këtë të drejtë.

Grevat kështu janë bo. Për bukë ma shumë, për pak të drejta ma shumë, për sjellje ma të mira ndaj të burgosurve të gardienëve, të personelit, për kushte pak ma të mira, për gazeta, për libra, për sjellje normale ndaj familjarëve që vijnë me na vizitu. Mos me marrë pjesë aty me na nejt te koka sigurimi me na ngu çka po flasim me nanën, e çka po flasim me babën edhe me u sjellë në ato mënyra që ata kanë ditë me u sjellë. Pastaj, vizita ishte në grila, domethonë, ti s'ke pasë mundësi të...

Anita Susuri: Kontaktit...

Naser Kuka: Kontaktit fizik, as me dhonë dorën as hiç, domethonë kështu. Po grevat kanë qenë të arsyeshme, kanë qenë të domosdoshme edhe për shkak të, të... se edhe aty bohej lufta, edhe aty ishte... se ishim të burgosur të pushtetit të cilët luftonin.

Anita Susuri: Po, nifare lloj rezistence.

Naser Kuka: Po, ishte rezistencë normal. Të burgosurit politikë kanë bo rezistencë kudo që kanë qenë dhe kanë ditë me u marrë vesh mes veti. Për shembull, ta zamë në Sarajevë nuk kam ditë sa të burgosur, a ka të burgosur shqiptarë, sa janë, tek janë. Po me ato format tonat të komunikimit përmes murit {sikur troket tri herë me dorë}. Ato i kemi pasë ato, domethonë...

Anita Susuri: Si trokitje, a qysh?

Naser Kuka: Trokitje, trokitje. Edhe na e dinim pastaj që paska edhe shokë tjerë mrena.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë kto trokitjet?

Naser Kuka: Po tashti kanë shku kohnat...

Anita Susuri: Nëse ju kujtohet.

Naser Kuka: Jo, më kujtohet, s'e harroj se osht' jetë, pjesë e jetës. Po, ne e kemi pasë, me gojë nuk do ta them po muj me i ra tavolinës se si ka qenë forma e trokitjes në mur.

Anita Susuri: Domethonë, ka qenë njo e caktume?

Naser Kuka: Po {troket në tavolinë}¹. Kjo ka qenë njëna nga këto (qeshë).

Anita Susuri: Shumë interesant. E, domethonë, dikuja ia keni bo kështu edhe ua ka kthy në atë formë...

Naser Kuka: Po.

Anita Susuri: Edhe e keni ditë...

Naser Kuka: E kemi ditë që kemi shokë aty.

Anita Susuri: Shumë interesant. Thatë që në burgun e Sarajevës edhe në Zenicë faktikisht, në burgun e Sarajevës nuk keni dalë jashtë, s'keni pasë të drejtë...

Naser Kuka: Jo, s'ka pasë, s'ka pasë të drejtë.

Anita Susuri: E në burgun e Zenicës pastaj sa ka qenë? Deri në lirim, sa keni qëndru?

Naser Kuka: Tashti, unë besoj duhet të ketë qenë 8 korrik ose gusht '83 kur jam transferu prej burgut të Mitrovicës në burg të Sarajevës, që ta kem të qartë unë edhe s'e kam ditë që jam në burg të Sarajevës. Unë kam ditë që jam diku larg Kosovës, për shkak të kohëzgjatjes së udhëtimit. Se ato automjetet e transportit të të burgosurve kanë qenë lloj qelish që ti s'ke pa jashtë kah je t'u shku. Po osht' ditë që je diku larg Kosovës. Pastaj, ne e dinim që ka të burgosur, se ishin, domethonë, ishin të stërmbushura burgjet e Kosovës.

¹ Troket me grusht mbi tavolinë me ritmin: "Republikë, Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë".

Fillunë qysh në '81-ten me nxjerrë edhe jashtë Kosove në burgjet e ish Jugosllavisë shqiptartë, i mbushën me shqiptarë. Ma mirrke menja që qaty diku jam edhe unë, ku i kanë çu tjetër ose ni pjesë të tjerëve. Pastaj, vonë e marrë vesh se jam në Sarajevë. Vonë e marrë vesh këtë punë dhe këtë përmes nanës kur më ka gjetë që jom aty. Se po i them, “Oj nanë edhe qitu më gjete a?” Tha, “Nana edhe në skej të botës me të çu të gjejë”. E se ish e ndalume komunikimi. Ata kishin thanë mos me folë mes vete veç me u pa. Po tashti unë s’muj nejta pa folë. Po i thom, “Leje moj në skej të botës, po kallxom ku jom” (qeshë). Edhe e morën pastaj nanën aty.

Anita Susuri: Ajo s’arriti me ju kallxu.

Naser Kuka: Ja, po, po. Ja nanën e kom pasë... nana ka qenë malësore. Nana tamam malësore e vaktit që mund të gjendet veç nëpër libra.

Anita Susuri: E kur keni dalë prej Burgut të Zenicës se ka qenë si lloj strategjie po më duket që e kanë përdorë, me ju liru ma herët ose që mos me ditë, po mendoj e dinit datën e sakt ose nuk e dinit po mos me ju liru në kohë të sakt.

Naser Kuka: Jo, e dinim. Unë e kam ditë se do të lirohem me 6 mars. Tashti, ne kurrë s’kemi ditë... për shkak se në burg të Zenicës nuk kemi pasë emër, aty kemi pasë numra amëzor, na kanë thirrë me numra. Unë e kom ditë numrin tim. Kur kanë thirrë me numër tim, jam lajmëru ku më kanë thirrë. Po ka qenë rregull, ka qenë rend shtëpiak që të burgosurit që kanë pasë me u liru me ni datë të caktuar janë liru prej orës 9:00 deri në ora 10:00 paradite, prej orës 09:00 deri në ora 10:00.

Kur mu më ikë kjo kohë, nuk më thirrën, atëherë fillova me dyshu që e kanë vendosë me më dënu se edhe në burg të dënonin. Ta mveshnin ni vepër ose s’ke pasë çka bon në burg dhe kështu diçka. Pastaj shkoj shumë kohë, dikur më thirrën, por nuk më thirrën për me dalë, më thirrën me u lajmëru te vetmitë, në objektin e vetmive. Shkova aty. Pastaj ma bonën ni kontrollë sikur kur t’hish në fillim të fillimit në burg, kur arrestohesh. Kjo pastaj e sforcuj bindjen time se e paskan vendosë me më dënu.

Më futën me ni qeli, më mbajtën aty ni kohë. Pastaj ma sollën ni pako brenda e hapa dhe po i shoh rrobat e daljes, rrobat civile, se ne kishim rroba burgju. I veshja ato rroba, thashë edhe nëse më dënojnë bile po dënohem tamam, a din (qeshë). Kur nuk zgjati, ka qenë mbramje orët e mbramjes. Më nxjerrin prej aty edhe më çojnë me ni zyre për të mi mbledhë betë edhe për të më tregu se shkova kah shkova aty e kom vendin, a po kupton? Kështu ishte ajo.

Zgjati ni kohë ajo, ajo biseda me, bisedë po them se ajo s’ishte bisedë. Ajo ishte me t’i mbledhë betë, me të kërcënu, po. Pastaj, më nxorën, e hapën derën dhe në oborr, para burgut e pashë nanën time që kish pritë aty gjithë ditën edhe ni vlla timin. U përshëndetën. Kujtova që kanë ardhë me veturë aty, thashë pshtum. Dhe harrova ta, do ta them se, nana po më thotë, “Pse s’e ke veshë ni vindjakne” [jakne]. Kështu diçka {prek jaknën që e ka të veshur}. “Po s’po narth, a din, nuk po narth”, tha, “Jo

vishe se rrobat t'i ka ble baba", "Po", thashë, "a ka vdekë baba?" Tha, "Jo, jo, veç pat' qef me të pritë në shpi". Ma mu ma mori mendja që paska vdekë.

Mirë, hypëm në tren se kta kishin ardhë me tren. Kur u nis treni erdhën ata të Sigurimit, policë, me na legjitimu edhe me na kontrollu. Unë s'kisha letërnjoftim e kisha fletëlshimin e burgut. Ma morën. Edhe nanën e kontrollun edhe vllaun e kontrollun. Tash nisë nga përvoja që kisha me të burgosur tjerë, unë krijova bindjen që paskan me më arrestu rrugës dikund. Sidoqoftë, mos te zgjasë, shkum në shpi, aty doli ai dyshimi im, domethonë, se shpijes i mungonte i zoti i shpisë.

Kishin dalë të lagjës sime disa në stacion, e disa para shpisë. Para shpisë krejt, domethonë, i madh e i vogël, me më pritë. Pastaj, pas disa ditëve, domethonë, mbajtëm takimin me ata shoktë tjerë që kishin vazhdu punën jashtë. Po nuk më lanën shumë se më morën dhe më dërgun në ushtri.

Anita Susuri: Cilin vit? A meniherë atë vit?

Naser Kuka: Meniherë atë vit. Meniherë në fillim. Kështu që, pastaj prej ni burgu në fakt shkova me ni burg tjetër.

Anita Susuri: Në cilin vend keni qenë në ushtri?

Naser Kuka: Në Banjallukë. Po aty vazhdunë ato format, format e randa të jetës tamam, vetëm se nuk ishe në qeli. Ushtria ka qenë burg i dytë i ranë për mu, po edhe për të tjerë shumë. Shkoi si shkoi ajo periudhë. Do ta them ni fakt që më kujtohet, më patën liru niherë atje, më thanë, "Hajt shko shtatë ditë te shpija". Ma dhanë lejën. Në fakt s'doja me shku se ishte fillimi që shkova ushtar edhe nuk e kishim atë lluks të lëvizjes ashtu, të shpenzimeve. Domethonë, po nuk e kundërshtova.

Para se me dalë prej kasarnës, kanë qenë telefonat, kabinat e telefonave. E thirra nanën me i thanë, me i kallxu që po vi. Mirëpo, sa e mbylla telefonin pastaj erdhën ata tjetër edhe më thanë, "Ku je t'u shku?" "Në shpi, e kam lejën". Ma morën lejën edhe nuk më lanë me dalë. Pastaj, përsëri ma dha ai që ma kish dhanë, ai eprori që ma kish dhanë të parën. "Shko se tash s'guxojnë me të nalë". E mora, prapë u nisa, prapë më kthynë. Ma morën lejën edhe më kthynë policia ushtarake.

Tash fillova me dyshu që ka naj plan rreth kësaj pune. Gjej ni mënyrë për ta ftuar nanën, ajo me ardhë në vizitë te unë. Erdhi nana me ni nip timin. Nuk më lanë me dalë në vizitë me u taku me nanën. Pastaj e nxora dikë, ni slloven, thashë, "Ni gru, e sheh, kështu, kështu... shko thuj, ajo s'din me folë, por të merr vesh. Dil e shko në qendër të qytetit se e gjej unë". Pastaj dikur m'u dha mundësia dhe dola për, dola pa leje prej kazermës. E gjeta qendrën e qytetit dhe e gjeta edhe nanën. Si nanat tona ish kthy me ni dyqan t'u pa reklama kështu.

E dija që nuk më lojnë gjatë me të po i thashë që, “Të kam thirrë, nuk është mirë gjendja. Nuk dihet si ndodhin zhvillimet rreth meje, po ti duhesh me ditë edhe shokve duhesh me ju tregu që nuk ka rrethanë në jetë që më detyron mu me bo vetëvrasje. Nëse ndodh kjo dijeni që më kanë likuidu”. Domethonë, e kisha thirrë për t’ia thanë këtë fjalë. Pastaj edhe më arrestun, edhe ndodhi kjo, më arrestun edhe më kthyn në kazermë. Në fakt, më çunë me ni dhomë paraburgimi edhe kështu.

Anita Susuri: Po pastaj a ka pasë gjatë gjithë kohës presion ndaj juve, a u rregullu pak gjendja a qysh?

Naser Kuka: Jo s’osht’ rregullu, jo. Domethonë, jeta ka qenë e randë në ushtri. Bile mund të them në aspektin psikologjik jam dëmtu ma shumë se në burg, në jetën e burgut. Se s’lishin me fjetë, gjithë natën nëpër biseda informative, nëpër malltetime, nëpër kërcënime, me t’i lidh sytë, pa ditë ku je t’u shku e tjera e tjera. Jeta ka qenë e randë, po kemi pasë vullnet për me u përballë edhe me atë. Vullnet, kemi pasë fuqi me u përballë me vështirësi, me cilado vështirësi.

Anita Susuri: Në ushtri keni qëndru 14 muj apo? Si tjethtë apo?

Naser Kuka: Jo, kom qëndru dymbëdhjetë muj.

Anita Susuri: Dymbëdhjetë muj.

Naser Kuka: Dymbëdhjetë, kështu ka qenë ushtria.

Anita Susuri: Dymbëdhjetë. E pasi jeni kthy prej ushtrisë, domethonë, ju keni qenë ni kohë në burg pastaj në ushtri, qysh jeni riaktivizu në aktivitet? Po mendoj keni vazhdu me aktivitetin sigurisht?

Naser Kuka: Po, po, menjëherë, meniherë domethonë. Se e thashë ma herët, pak ma përpara ka dalë ai Hyseni, ka kry dënimin prej tre vitesh e gjysmë. Brenda kësaj periudhe, derisa unë kom dalë, ai ka arritë me i, me i vu në lëvizje...

Anita Susuri: Me riorganizu.

Naser Kuka: Me riorganizu ato radhë që kanë qenë. Me i nxjerrë në rend punët e strukturave tona dhe kështu që nuk ka qenë e vështirë tashti qysh në fillim me i marrë informacionet për gjendjen edhe me vazhdu punën bashkë aty ku e kishim lonë. Bile edhe ma intenzivisht sesa që kishim punu deri atëherë.

Anita Susuri: Keni vazhdu me shpërnda shkrime, traktate të ndryshme?

Naser Kuka: Kemi shpërnda edhe trakte edhe kemi shtypë edhe kemi shumëzuar materiale të ndryshme. Nëse s’gabohem pastaj, se të njejtën kohë, unë isha në kontakt edhe me struktura të OMLK-së që vepronin në Ferizaj edhe në rrethe të tjera. Në atë kohë u morëm vesh për shpërndarjen e

traktit, “Thirrje popullit të Kosovës dhe viseve shqiptare”, domethonë shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi, në Kosovën Lindore. Trakt i cili shpërndahet në atë kohë, besoj, në krejt komunat shqiptare.

E kemi shumëzuar, e kemi rritë atë numrin e trakteve. Po ishte kjo kohë e lëvizjeve të mëdha edhe e ni ofanzive që Jugosllavia e kish ndërmarrë në Kosovë përmes demonstratave të serbëve, malazezëve e tjera e tjera. Është edhe koha kur ishim bindë definitivisht që janë kriju rrethanat për ni lëvizje ndryshe në Kosovë, për ni rezistencë ndryshe në Kosovë. Ka qenë në tavolinë të diskutimeve edhe ni lëvizje e gjërë popullore legale. Le të na burgosin, le të na vrasin po duhet me masovizu lëvizjen tonë, duhet.

Prej ni lëvizje të ngushtë e të vogël, me bo ni lëvizje të madhe të fuqishme popullore. Domethonë, janë diskutu, i kemi diskutu në atë kohë këto çashtje. Po kur ishim në, ishim bash në atë vrullin e madh të punëve, domethonë përsëri erdh koha, erdh dita kur, kur, kur duhej të përballeshim me fatin e jetës tonë, domethonë, me arrestimin, me burgosjen.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Pikërisht deshta me dalë aty në vitin ‘88 se osht’ edhe martesë ju me zonjën Afide, po osht’ edhe arrestimi i ju.

Naser Kuka: Po, po.

Anita Susuri: Fillimisht si jeni njoftu me zonjën Afide?

Naser Kuka: Po na kemi qenë të njoftum, se Afidja ka qenë në struktura të këshillit organizativ të rrethit për Ferizaj. Pastaj, kjo ka qenë e arrestume me 26 mars, ‘81, bashkë me shoqe tjera. Pastaj osht’ dënu në ‘84, që s’ka qenë, domethonë, osht’ dënu bashkë me të tjerët në vitin 1984 dhe veprimtaria na ka njoftë. Nuk ishte koha për ksi ceremonish, se nuk osht’ dytësore por për bindjet tona në atë kohë kjo kishte kalu në rend të dytë, kjo çashtje.

Po unë e kisha nanën që rrinte për ditë, “Hajde ma, hajde ma, hajde ma, hajde ma”. Kështu që, përfundimisht u morëm vesh që po e kryjmë martesën. Ndoshta s’na lanë asni ditë bashkë, po ne po e zyrtarizojmë dhe pastaj qysh të vijnë hesapet. E kemi pasë ni, jemi marrë vesh për martesë e me bindje se nuk do ta kalojmë lehtë, lehtë jetën tonë. Normal që në këto biseda ka bo pjesë edhe rezistenca e armatosur. Nëse më jipet mundësia, nëse na jipet mundësia në burg ma i gjallë nuk shkoj. A po më kupton? Kshtu ka qenë.

Afidja, ktu nuk flas si bashkëshorte, flas si shok pune, si shok lufte, ka ditë në jetën e saj se çka bon. Edhe ka qenë e gatshme me u përballë me të gjitha vështirësitë që i bën jeta në rrethana të pushtimit edhe të luftës kundër pushtuesve. E bonëm edhe ni dasmë në këtë, në këtë hesap. Dasmën ma shumë

për inat të pushtetit. Se ju jeni t'reja ndoshta s'pe di a din, po nuk ka qenë lehtë me u martu dy ish të burgosur politikë. Nuk ka qenë ni vendim i lehtë. Për shkak se ma s'ke qenë vetë. Ma osht' ditë që nëse shkon ti, shkon vet i dyti, nuk shkon ma vet. Mirë edhe e bonëm ni dasmë.

Hajt morëm ni vendim s'paku nga ni shok prej komunave të Kosovës, ish të burgosur shokë me e pasë aty. E në mesin e tyre e thirrëm edhe Ukshin, Ukshinin, Ukshin Hotin. Përndryshe, unë Ukshinin e kam pasë vizitor të rregullt në Kaçanik, në shtëpinë time edhe para kësaj. Ndejtëm. Kur u djeg shpija gjatë luftës, më janë dhimtë shumë letrat, dokumentet, libra që më janë djegë, po më është dhimtë edhe ni komplet gotash që ma ka pasë pru Ukshin Hoti për, për dasmë. Desha të them se Ukshini ka qenë, kur, në martesën dhe mos gabofsha për herë të parë në jetën e tij ni gotë konjak, "Skënderbeg", e ka pi në këtë dasmë.

Po kjo, kjo punë e kësaj martese nuk zgjati shumë, se ditën që ne i mbushëm tre muj martesë, unë marrë ni sinjal se mund të arrestohem, pritet me ndodhë kjo. Po unë marr për vete, domethonë, jo për bashkëshorten. Sidoqoftë, ia komunikova këtë lajm që kisha marrë fjalë mas fjale që më kish ardhë, domethonë, që pritet me ndodhë kjo dhe ka mundësi që do të detyrohem me u largu prej Kosove. Pastaj e diskutum edhe me ni rreth ma i ngushtë i shokëve dhe u përcaktum që unë, po dyshohej që edhe njëni prej shokëve meqë edhe përpara kishte qenë në burg, Hyseni, edhe ai mund të jetë në listë. Atëherë u morëm vesh që bashkë me dalë, me u largu.

Komunikum, i vendosëm lidhjet me shokë në Gjermani edhe në Zvicërr edhe me organizu daljen jashtë Jugosllavisë. Morëm masa, u përgatitëm ashtu. Unë nuk kom pasë, pas daljes nga burgu, dokument, domethonë, se në fakt pasaportën më është konfisku, domethonë, meniherë mas kthimit nga Shqipëria në '81-tën. Por, as Hyseni nuk ka pasë pasaportë. Shoktë jashtë vendit na sygjerun që të dalim kah Italia. Ata me dalë me ni qytet kufitar të Jugosllavisë me Italinë e me na pritë. Në mesin e tyre ishte edhe ni vlla i Afidës. Na hynëm në Itali, me shumë vështirësi, e dolëm se s'kishim dalë najherë që me ditë rrugën. Kemi ecë në orientim diellor domethonë. Dolëm, po në ni moment policia italiane na kërkon, na legjitimon, na lypë dokumente. Unë ia nxora ni leternjoftim të ni vllau tim edhe kështu.

Nejse, përfundimisht na lidhën, na arrestunë, na çunë në ni stacion të gjandarmërisë së tyre. Na fotografun, na i morën gishtat e tjera. Po nga librat, nisë nga librat unë po ju kërkoj, e dija që, *kuestur*² domethonë sigurim. Në bazë të literaturës se nuk dija italisht, s'kisha qysh me folë me ta. Edhe po ju them që me na çu në *kuestur*, atyne policisë italiane. Ata na çunë aty po përkthyesin e kishin marrë ni konsul jugosllav. S'paku ai kështu u prezantu, se na përshëndeti serbisht. Mos të zgjatëm ktu po përfundimisht na dorëzunë në organet sllovene në kufi me Slloveninë.

Pastaj, na nxorën meniherë atë ditë na nxorën te gjykatësi për kundërvajtje në Gjykatën e Koprit. Dënimi, na dhanë ni dënim nantë ditë burg për kalim ilegal të kufirit. Unë kërkoja që këtë dënim me

² Ital.: *questura*, në përkthim stacion i policisë.

burg me na shndërru me pagesë, me i pagu ato nantë ditë burg. Po, t'u mendu që nuk e dijnë kush jemi. Gjykata na e boni dënimin me pagesë, na dënoi nëntë ditë me mundësi të pagesës së dënimit. Po tha, "Kur të shkoni në burg e lypni arkatarin ia bijnë arkatarin e boni pagesën edhe ju lirojnë prej burgu". Mirëpo, s'ish konë ky ren. Thojshin, "S'osht' sot, vjen nesër", "S'osht' sot, vjen nesër".

Na mbajtën nantë ditë aty, e kryjtëm dënimin. Na lidhën edhe na prunën në Kosovë, na dorëzun në Kosovë. Pastaj ktu u morr vesh se ka ndodh arrestimi edhe që në burg është edhe bashkëshortja. Domethonë, u morr vesh kjo punë. Po, për dallim prej herës të parë, tash hetimet e kësaj burgosje janë zhvillu në Sekretariatit e Punëve të Brendshme të Mitrovicës. Këtu ka qenë pak më vështirë, më vështirë për, sidomos, për bashkëshortën e cila ishte në atë kohë shtatzanë. Gjendja e saj e vështirësonte edhe gjendjen time.

Sidoqoftë, domethonë, e kalum edhe këtë fazë të randë e të papërshkrueshme timen dhe dolëm pa asni pasojë. Përveç pasojave tona që kemi nejtë në burg, domethonë pa asni pasojë tjetër si rezultat i, si rezultat i hetimeve kur një grua e ke shtatzanë, e rreh, e din që osht' t'u nejtë në ni qeli dhe kur vet po ashtu je në qeli. Dhe kur hetimet zgjasin me muaj, kur nuk ngelet formë e dhunës që nuk osht' përdorë në trupin tonë. Pastaj vjen në atë situatë që të komunikohet vendimi, dita e daljes në gjykim dhe i gëzohesh kësaj pune se s'paku janë ndërpre hetimet. Ke dalë mirë, je nda mirë, shoktë jashtë vazhdojnë punën e me fatin tonë le të ndodhë çkado që ndodhë.

Anita Susuri: A ka qenë zakonisht brenda hetimeve kur ka qenë dhuna apo edhe kështu kur jeni dënu?

Naser Kuka: Jo, ndaj neve të burgosurve politikë, dhuna fizike osht' përdorë kryesisht, domethonë, gjatë hetimeve ose për naj rast të caktum tjetër. Po kjo ka ndodhë në lokalet e Sigurimit Shtetnor, jo mrena në burg. Domethonë, të ka nxjerrë prej burgut, të ka çu në lokale të Sigurimit, ke qenë durë lidhur ose të kanë lidhë për diku tjetër në ato nxemjet çka janë ato gypat. Dhe ata pastaj, ato kanë qenë forma që janë përdorë te secili. Nuk ka ndodhë kjo te ni i burgosur veçmas.

Por, megjithatë, them që ne, personalisht unë, kur osht' mbyllë procedura hetimore, kur kanë dalë në gjygj dhe kanë pa që nuk ka shokë tjerë, nuk ka marrë me vete dikë, unë e kam konsideru fitore. Unë kom fitu mbi UDB-në dhe kom fitu sa herë kom fitu, krejt jetën kom fitu. Ata kanë fitu që na kanë shkatërru trupin, po s'kanë arritë me na mposhtë, s'kanë arritë me na detyru me thanë ata që s'dojmë me thanë kurrë, asniherë!

Anita Susuri: E në këtë kohë sa jeni dënu?

Naser Kuka: Katër vjet jam dënu, sikurse edhe dënimin e parë. Pastaj, ky dënim më zbretet në dy vite, se në fakt, me thanë të vërtetën nuk kanë pasë prova për me më dënu. Ndoshta edhe më kanë dënu veç për shkak të qëndrimit në gjygj, domethonë qëndrimit që kam mbajtë në gjygj edhe gjatë hetimeve. Nuk diskutohet kjo se na e kemi mbrojtë edhe para, edhe gjatë hetimeve edhe në seancë

gjqësore kërkesën për Republikën e Kosovës. E kemi mbrojtë edhe e kemi arsyetu, se nuk kanë pasë fakte, dëshmi. Kanë qenë punë të vogla ato që e kanë ditë ata. Domethonë, s'kanë qenë gjasat për me më dënu katër vite. Po unë sikurse edhe tjetër e kom mbrojtë atë kërkesën edhe e arsyetova kërkesën për Republikën e Kosovës si kërkesë e drejtë, e domosdoshme për t'u realizu, që ni ditë ne do ta fitojmë luftën, patjetër. Dhe kështu u dënova dy vite dhe aty dikund i kom mbajtë domethonë.

Jom liru se gjatë kësaj periudhe ishim në burg të Mitrovicës, bashkëshortja ka qenë në pavionin e vajzave, grave. Po unë kam qenë në katin e dytë. Nana si zakonisht vinte në vizitë te unë e pyeta, "A e ke pa Afidën?" Në ni rast ndodhi që tha, "Jo, po e kryj me ty edhe pastaj me Afidën". Thashë, "Jo, mos hajde te unë pa shku niherë te Afidja". Se doja me ditë gjithmonë gjatë vizitës me marrë vesh edhe për Afidën, po. Dhe në ni rast kësisoji, nuk sillen mirë me nanën, se ajo më jepke gajret, "Hajt bir mos ki gajle, hajt kështu, hajt ashtu..." Ni ditë nuk u sillen mirë organet e burgut, drejtori i burgut edhe ai Sigurimi që i përgjonte bisedat.

Pastaj, unë protestova dhe hyna në grevë urie me kërkesë ekstreme, domethonë, largimin e drejtorit prej burgut, drejtorit të burgut prej aty, me kushtin e jetës. U bindën, u përpoqën me ma mbushë mendjen që me thy grevën, me ndërpre grevën e kështu ashtu. Nuk e ndërpreva. Pastaj m'dukët, pas 12-13 ditësh më transferojnë në burg të Prishtinës. Tash unë me këtë fakt e vështirësova jetën e nanës, se tash u dashke domethonë me shku në gjykatë, me ardhë në Gjykatë të Prishtinës me marrë leje për Afidën, me shku me pa Afidën. Me u kthi, me shku prapë në gjykatë me marrë leje për mu, me ardhë te unë. Dhe kjo pastaj erdhi në shprehje hala ma shumë kur prej burgut të Prishtinës me transferojnë në burg të Gjilanit. Tash ajo e shkreta, vrapo anej, vrapo knej. Vrapo anej, vrapo knej.

Kjo ka qenë në fakt, në periudhën e para gjykimit kjo që e thashë se gjatë gjykimit Afidja osht' liru për nantë muaj derisa t'i bon fëmija nantë muj. Kështu më dukët ka qenë vendimi. Por, jo veç Afidja, se ka qenë edhe ni shoqe e Afidës në gjendje të njejtë. Po. Edhe ikëm. Përfundoi, e kam përmbyllë në burg të Gjilanit, prej aty kam dalë prej burgut edhe kam shku në shpi.

Anita Susuri: Në datën e sakt që ju kanë liru apo?

Naser Kuka: Valla nuk ka qenë se po e ndërlihi me, osht' ndonjë ditë përpara për shkak se po të kishte qenë atë ditë kish ardhë nana me më pritë para burgut. S'ka ardhë kush, kom shku me taksi në shpi. Nuk ka qenë, diçka ni ditë. Unë kur kom dalë pastaj, kom pa gjërat. Do t'ja u jap edhe atë, se përfaqësuesi i degës Amnesty International që kishte, gjerman, që ka qenë për Gjermani e i caktum si grup për me u marrë me mu prej qendrës së tyre. Ata kishin pasë shkru shumë ma herët letër, ni Richard Green ka qenë në familje që në emër tim t'u më uru që kom dalë prej burgut, e t'u më lypë me më shkru se si e kam kalu jetën në burg e tjera. Por, unë në fakt kto letra i kom gjetë kur kam dalë prej burgut. Ata me siguri, nisur nga përvojat, kanë marrë ndonjë njoftim jo real prej, ku di unë, prej organeve të ndryshme dhe...

Anita Susuri: Sa keni qenë ju në burg ju kanë shkru juve ata?

Naser Kuka: Mu po me adresë të shpisë, me adresë të shpisë. Unë ato letra i kom lexu kur kom dalë prej burgut, në shpi. Desha të them që unë kam qenë nën mbrojtje të Amnesty International, po shumë gjëra i kom marrë vesh pasi kam dalë prej burgut. Po si burg e kam mbajtur, domethonë. Tashti a kom dalë ni ditë a dy përpara a përmbapa nuk osht' me randësi ajo. Pas daljes nga burgu, tashti ishte ni gjendje tjetër...

Anita Susuri: Viti '90 apo?

Naser Kuka: Po, po mesi i '90-tes. Afidja erdh koha kur kjo duhej të paraqitej në burg...

Anita Susuri: Sepse asaj i kishin dhanë leje me dalë prej burgut.

Naser Kuka: E kanë liru, osht' vendim gjykate. Kta edhe atë shoqen e saj i kanë liru për shkak të gjendjes shëndetësore deri t'i mbush nantë muj fëmija. E ka në vendim datën kur duhet me u paraqit në në vujtje të dënimit. Pastaj më duket që e kemi shty lidhje mas lidhje domethonë, e kemi shty edhe për ni kohë derisa të pushoj unë pak, ta merr vetën kështu. Por, sidoqoftë kjo kohë e jetës të Afidës është ilegale, kryesisht krejt osht' ilegale, ka vazhdu kështu. Në, ky vit po shkruhet. Tash me ni, me ni ndryshim të strategjisë së punës dhe veprimtarisë tonë.

Ma nuk bohej fjalë për shpërndarje traktesh, e gazetash, e librash. E vlerësum që ka ardhë momenti që duhet të ndryshojmë edhe ne në punën tonë. Dhe u përcaktum që përfundimisht, definitivisht me ndërpre aktivitetin politik ilegal, propagandistik, domethonë çdo ditë që bonim deri atëherë. Celulat ilegale të organizume me i shndërru në celula të armatosura, njësite të armatosura dhe veprimtaria jonë me u zhvillu në sigurimin e armëve, në organizimin e njësiteve, në zgjerimin e njësiteve e kështu. Domethonë, me u përcaktu definitivisht për përgatitjen e popullit për luftë të armatosur me Serbinë.

Kjo periudhë përshkruhet e derisa arrestohem për herë të fundit, se osht' edhe ni arrestim që ka ndodhë me 31 janar '94 në Ferizaj bashkë me të tjerët. Në ni festim ishte flaka e janarit. Po gjatë vitit '90, e '91 ne arritëm me shtri në qendrën urbane pothuajse në çdo lagje me formu nga një njësit. Diku ma t'gjanë, diku ma t'ngushtë edhe në, në fshatat e zonat periferike domethonë të qytetit të Kaçanikut. Pastaj vjen ni periudhë, se osht' dashtë me u marrë pak njerëz me krejt puntë. Me siguru armë, me siguru monicione, me siguru shpërndarje, njësitin e shpërndarjes.

Diku në '92-ten, në janar të '92-tes nëse nuk gabohem se datat mund të lëvizin në secilin rast, unë marrë ni informacion që vjen ni, në fakt ni selam, ni porosi që duhet të largohem prej Kosovës se jam rreziku shumë. Në fakt nuk e dija se jam rreziku. Ne ishim t'u bo punë, mirëpo që osht' dekonspiru diçka nuk e dija këtë punë, se edhe s'ka ndodhë. Sidoqoftë, nuk, nuk mund të largohesha vet e ta lija

bashkëshorten me fëmi. Kështu dhe u morëm vesh që s'paku kjo me dalë, meqë kishte vlla, e kishte ni motër në Gjermani, së paku kjo me qenë e sigurt edhe me neve le të ndodhë çka të ndodhë.

Anita Susuri: Atëherë tre fëmi më duket i keni pasë?

Naser Kuka: Po, i treti ka qenë pak ditësh. U dashtë shpejt e shpejt se kështu më erdh porosia, shpejt e shpejt domethonë, meniherë. Dhe shpejt e shpejt meniherë ndërmarrë masat e nevojshme dhe nisemi për Dibër bashkë me Afidën. Për Dibër, ne s'kishim dokument, për Dibër me dalë malit. Na u dashtë disa ditë me nejt në Dibër. Ni lidhje që e kishim marrë lidhje mas lidhje se na nuk e kemi njoftë.

Me vete kisha edhe dy shokë të Kaçanikut dhe, po kto nuk i kom lanë që të afrohen në zonën e rrezikut dhe ni shok të Gjilanit edhe ni të rrethinës së Lipjanit. Po kta dy osht' dashtë udhëtimin e malit me e bo me mu. Tashti, pas qëndrimit disa ditësh në Dibër, te ai Hakiu, nuk më kujtohet mbiemri. Ata normal janë kujdesë si për familjarë të tyre për ne. Ajo e zonja e shpisë osht', e ka lutë Afidën që këtë fëminë e vogël, vajzën, me ia lanë që ajo të kujdeset për rriten e saj derisa, derisa të krijohen mundësitë me na sjellë diku, kudo që të jemi ne e tjera. Po normal ashtu.

Përfundimisht, kur u kry krejt përgatitja u bo puna që duhej të bëhej, u nisëm në rrugë malore dhe dolëm në, dolëm në Shqipëri. Kalum kufirin. Jo lehtë, mjaft rëndë, mjaft vështirë. Vështirë rruga për me dalë deri aty. Pastaj e vështirë edhe rruga me e bo nga, nga ato fshatra kufitare domethonë. Osht' ni lagje Capaj aty e me shku në Peshkopi e prej Peshkopisë pastaj me shku në Tiranë. U bojshin dymbëdhjetë orë rrugë në atë kohë. Pastaj edhe s'kishe ku me shku. Unë kisha disa pika se kisha hy, po kisha hy për punë, domethonë, tashti isha ndryshe nuk isha...

Anita Susuri: Vet.

Naser Kuka: Vet. Sidoqoftë, domethonë, u bo ni zgjedhje e mirë, kalum mirë edhe vështirësi kalum shumë. U përballëm me ni jetë jo të lehtë edhe kështu. Na zbulunë italianët se pasaportat ishin të hujat domethonë. Na mbajtën disa ditë me ni dhomë izolimi ashtu në kushte mizerje edhe shpëtum. Ishte fat i yni i madh që kisha njerëz kështu dhe shpëtum pa na dorëzu në Jugosllavi. Domethonë se kështu ishte, ishte përgatitë tereni. Pastaj, kthimi në Tiranë ishte si me na kthy në shpi, se s'kish gajle ajo, se dështoi projekti për nxjerrjen e Afidës jashtë se ky ishte qëllimi. Pastaj unë, vjen dikush më informon se e kam nanën shumë të sëmurë edhe e marrë vajzën e madhe për dore malit edhe vijmë te shpija.

Pjesa e Pestë

Naser Kuka: E mora vajzën, pas marjes së lajmit për gjendjen e randë shëndetësore të nanës e marr vajzën e madhe, Besfortën, dhe nisemi rrugës malore përsëri dhe vijmë në Kaçanik. Aty ndejtëm nja tre-katër ditë derisa u binda që nuk e ka vendosë me ecë prej kësaj jete. E lash vajzën, pastaj u ktheva

vet përsëri të njejtës rrugë. E mora bashkëshorten dhe dy fëmitë tjerë, Boletinin e Shkëndijen dhe përsëri malit edhe me kta shkum në shpi.

Po vet fakti që s'kishte ndodhë asni ftesë, nuk më ka kërku kërkush në shpi, domethonë e boni atë lajmin, porosinë që ma dhanë mue me gjithë ato siklete, vështirësi, rreziqe jo serioz. Po mu më duhej me marrë masa, meqë më kish ardhë porosia. Vazhdum ne punën, jeta vazhdoi normal me ato problemet që ishin. Herë legal e herë gjysmë ilegal. Kjo vazhdoi kështu deri në, me 31 janar '94. Me 31 janar '94 arrestohem unë bashkë me, nëse nuk gabohem me 41 të tjerë në shpi-shkollë të Hysri Varoshit në Ferizaj.

Gjatë këtij arrestimi u dëmtova fizikisht shumë dhe realisht pastaj edhe u bo e pamundur qëndrimi im i matutjeshëm në Kosovë. E para për shkak të gjendjes fizike, e dyta për shkak të pamundësisë të vazhimit ma tutje të punëve. Pas qëndrimit në kohë në fshatra të Kaçanikut... po unë kam qenë në gjendje ku s'kam mund me lëvizë fizikisht.

Anita Susuri: A ka qenë kjo koha kur në rrugë ju kanë lonë?

Naser Kuka: Po, domethonë, nuk kam mund me ecë, s'kam mujtë me lëvizë, s'kam mund me u ngrit...

Anita Susuri: Ju kanë dëmtu shumë.

Naser Kuka: Jashtëzakonisht shumë. Dhe në këtë gjendje pas në kohe, se ishin dy rrugë, domethonë, e treta nuk ekzistonte: me më zanë edhe me më burgosë ose me më vra. Domethonë, s'kishte rrugë tjetër. Më nxjerrin shoktë, dal në Maqedoni te disa kusheri të nanës. Kam qëndru në kohë edhe aty me ilaqe e kështu, domethonë, popullore. Diku në fundin e marsit ose prillit përsëri përmes shokëve e përmes ndihmës së dibranëve, arrij me dalë në, me kalu kufinin Maqedoni-Shqipëri dhe me dalë, me kalu në Tiranë.

Paraprakisht Afidja, domethonë, veç kishte bo në zgjedhje, ajo tjetër gja. Tash unë isha vet, isha pa naj problem shtesë përveç problemit tim. Po kjo edhe shënon fundin e në periudhe, domethonë, fundin e veprimtarisë sime aktive me pjesëmarrje fizike në Kaçanik edhe në Kosovë. Pas shumë tentativave telasheve të mëdha, megjithatë kam arritë me dalë në Gjermani. Fillimisht në Zvicërr, në natë kom bujtë aty te në shok i imi dhe ai pastaj më ka përcjellë me veturë të vetën deri te familja e Afidës, te vllau i Afidës në Gjermani.

Me 24 prill '94, domethonë në ditë pas daljes sime në Gjermani, unë paraqitem në qendrën për azil në Gjermani. Kjo domethonë, tash kalojmë veç me në formë tjetër të punës, me në fazë tjetër edhe të jetës edhe të punës. Hala pa, mund të them, nuk jam dalë, nuk jam ndalë me i vajtu varrtë ku po më dhëm ma shumë e tjera. Kemi fillu edhe aty me punu, kemi punu çka kemi pasë mundësi me punu. Domethonë, me në shtet tjetër me punu për vendin tand.

Azili na njihet shpejt, domethonë, pasaportat i marrim shpejt me ni periudhë të shpejt kohore. Po me '95-tën më thirrë nana thotë, "Deri ktu e kam shty me zor, ma s'muj me e shty se edhe s'po na dojnë me telashe, s'po kemi ku me shku. Po kam frikë se po m'i marrin fëmijtë", se në fakt i kërkonin fëmijtë për me bo presion për dorëzimin tim edhe tha, "Bile fëmijtë merri. Bonja qysh të mundësh merri fëmijtë". Marr masat e duhura, domethonë, dhe udhëtoj për Tiranë. Vendosi kontakte në Ladorishtë me shokë të mi, bazat që i kam shfrytëzu në vazhdimësi dhe e organizoj sjelljen e nanës në Ladorishtë edhe të fëmive.

Pastaj, me përkrahjen e grave dhe burrave të Ladorishtit edhe ata dalin në Shqipëri. I marr i vendosi në Elbasan diku te disa miq të mi dhe meqë për nanën u paraqit problem procedura, domethonë, u dashte me prit disa kohë. Për fëmi nuk ish ai problem se rregullohej meniherë mrena ditës procedura e transferit në Gjermani. Megjithatë i përdora ato forma të mija të ni rreziku po edhe nanën edhe fëmijtë i mora bashkë në Gjermani, nuk i ndajta. Domethonë, për ni ditë. Nuk pat' telashe. Të nesërmen i paraqita në qendrën e azilit. Ju tregova qysh i kam sjellë në Gjermani, kështu domethonë në këtë mënyrë se s'kishe ndryshe. Vazhdoj edhe tashti nuk e kishim s'paku edhe problemin e fëmive edhe të nanës, se ishte plakë ajo.

Anita Susuri: Çfarë moshe kishte qenë nana juje në atë kohë?

Naser Kuka: Po tashti...

Anita Susuri: Diku 70 vjet?

Naser Kuka: Mbi 70 vjet. Pastaj vazhdum, vazhdum edhe aty përmes klubeve, përmes shoqatave. Me formu shoqata, sidomos, osht' ni qendër kulturore shqiptare në Sindelfingen, në rrethin të Stutgartit, "Isa Boletini". Aty fillimisht fillova me, me vu në dispozicion vetën për angazhime e punë në interes të bashkatdhetarëve dhe në interes të Kosovës. Pastaj, gradualisht ndërmarrim iniciativën edhe për formimin e Shoqatës së Intelektualëve në Gjermani. Pastaj e bonëm edhe ni lloj bashkësie shqiptaro-gjermane edhe fillum me aktivitete që ne i konsideronim se janë në interes të Kosovës.

Njëna nga këto ishte informimi i opinionit gjerman për gjendjen në Kosovë. Përmes shtypjes dhe shpërndarjes së fletushkave të ndryshme, përkthimit të atyre në gjuhën gjermane dhe përmes aktiviteteve tjera që vlerësoheshin në ato vite se janë në interes të Kosovës. Kjo shkoi deri diku në '96-'97, takime me bashkatdhetarë, jo veç në Gjermani po edhe në shtete tjera. U dashtë në atë periudhën e viteve '96-'97 me u orientu ma shumë rreth zhvillimeve në Kosovë. Me siguru armatim, me siguru njerëz, me siguru logjistikën e nevojshme, me gjetë vullnetarë që janë të gatshëm me vdekë për këtë vend. Kështu derisa doli në sipërfaqe publike Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Kam qenë, na secili jemi marrë me krejt puntë, nuk jemi marrë veç me ni punë. Çdo gja që është kërku që mund të bohet, osht' ba. Nuk ka qenë me rëndësi, e kam ni detyrë valla edhe qit' detyrë po e boj. Ke mujtë me bo detyra tjera, me kry punë tjera i ke kry edhe ato tjerat. Po kur u bonën njerëz boll, unë, domethonë, deri atëherë kryesisht jom angazhu për sigurimin e logjistikës, për sigurimin e armëve, e municionit për luftë. Unë me të tjerë, s'e kam bo këtë punë punë. Kam qenë në atë sektorin e veçantë, domethonë, të shtabit të përgjithshëm, domethonë të logjistikës.

Kemi vazhdu kështu, kemi hy, kemi dalë, kemi kry ato punë që osht' dashtë me i kry. Deri në, deri në hyrjen e forcave të NATO-s dhe vendosjen e qeverisë së përkohshme në Prishtinë, e shtabit të përgjithshëm. Pastaj, deri në 2002 jam marrë sporadikisht, do të them, për hatër ma shumë me edhe me përgjegjësi politike të nivelit lokal të komunës së Kaçanikut. Po ky vit edhe shënon fundin tim, tërheqjen tem përfundimtare prej aktiviteteve dhe përmbylljen e historikut të jetës time, angazhime për çështjen e Kosovës.

Ajo që, ajo që osht' ni kapitull historie që e prekëm pak, e prekëm e në fakt do të duhej më shumë të flitej periudha '90-'91. E cila po shkruhet edhe besoj do të njihet ni ditë si kohë kur në mënyrë të organizuar prej ni subjekti me traditë të madhe të veprimtarisë ilegale ndërmirret vendimi, mirret ni vendim, osht' ni vendim, osht' marrë ni vendim për atë që thashë, ndërprejen e aktivitetit politik ilegal dhe kalimin e celulave ilegale të lëvizjes në formacione të armatosura.

Pastaj, në '91-tën në mujin shtator '91, kur i dërgojmë rekrutët e parë të Kosovës për përgatitje ushtarake për nevoja të luftës në Kosovë, domethonë, në mujin shtator '91. Ktu ka qenë, osht' edhe dora jonë e punës, e angazhimit edhe e përgjegjësisë. Kto dy periudha, për shembull, janë që hala lypin kohë për t'u zbardhë në tërësi ashtu siç kanë qenë në fakt. Kanë punë historianët, ata që mirren me ndriçimin e proceseve në këtë periudhë kohore se ka shumë gjana që hala i mungojnë dritës për t'u parë.

Konkret asaj që e thashë pak ma herët, lidhur me organizimet e armatosura përkatësisht formimit të njësiteve të armatosura në qytetin e Kaçanikut dhe rrethinën e saj. E cila daton nga viti '90, gjysma e dytë e vitit '90 po që ka pasë ni zhvillim të hovshëm në shtrirje, në ngjeshje radhësh, në forcim radhësh dhe përgatitje praktike për ni rezistencë të armatosur. Ishin rrethana tjera ato. Si krejt shqiptartë tjerë edhe ne si organizim shpresën e besimin e dritën e vetme të përkrahjes, mbështetjes e shihnim në Tiranën zyrtare.

Në këtë drejtim, kemi bërë rrugë të gjata jo me pak vështirësi, jo me pak rreziqe për të, për të parë se çka mund të bohet në këtë relacion në kuptimin e sigurimit të kanaleve të rregullta të furnizimit me armë dhe të përgatitjen e rekrutëve, të rinjëve të Kosovës për luftë. Në aspektin formal, domethonë, ka pasë gatishmëri, domethonë, deri në '92-tën së paku në relacionet në të cilat unë kom lëvizë dhe personalitetet me të cilat unë kom kontakti atyre viteve. Flas për '90, domethonë fundi i '90-tës, '91, '92, '93. Kom shku disa herë, jo pak.

Po përderisa deri në vitin '92 kanë ekzistuar, i kemi pa dhe na osht' thanë edhe zyrtarisht se depotë e armëve për Kosovën, për vllazërit kosovar i kemi të veçanta, domethonë, kanë qenë të parapame për Kosovën, për shqiptarët jashtë Shqipërisë administrative. Pastaj, në këtë periudhë edhe u realizua ai projekti për dërgimin, fillimi, domethonë për dërgimin e rekrutëve të ni grupi të vogël do të thosha, po të madh për nga rëndësia historike, që të njëjtit të dërgohen edhe të priten zyrtarisht, të vendosen në Currel te Dajti i Tiranës dhe me ta të punojnë ushtarakë të njohur, ushtarakë në za në Ushtrinë e Shqipërisë, në armatën e Shqipërisë.

Pas '92-tes, në fakt '92 e këndeje, gjërat në këtë drejtim kanë lëvizë, nuk janë zhvillu në pritshmëri që ne kemi pasë. Dhe, në fakt, edhe me ndrrimin e pushteteve u ndërpre edhe ajo mundësi e dërgimit të të rive për, për përgatitje për luftë. Nuk osht' ndërpre krejtësisht se në kanale, në kanale do të thosha private, po as ajo nuk është private përderisa njerëz zyrtarë kanë punu me ta. Po jo më në poligone të ushtrisë, flas pas '92-tën, kur osht' punu, oficerë të ushtrisë shqiptare kanë punu me të ritë e Kosovës për përgatitjen e tyre për luftë. Por, ta zamë njëna nga pikat në Stadionin e Klubit Futbollistik, "Partizani", aty janë trajtu. Kjo ka vazhdu, domethonë, herë me ni tempo ma të hovshëm e herë me ni tempo ma të ngadalshëm, por nuk është ndërpre.

Kur jemi ktu, më duhet të them se kjo strukturë organizative që kishte marrë përsipër bartjen e përgjegjësisë për përgatitjen e luftës atyre viteve, në nëntorin vitin e '94, dha edhe dëshmorin e parë të saj, të radhëve të saj. Ismail Raka, si njëri nga militantët e këtij organizimi, prej filleve të para të ekzistencës arrestohet dhe mbytet në torturë mrena 24 orëve. Mbytet pa ia dëgju zërin xhelatët e tij. Domethonë, qëndresa e tij, heroizmi i tij para xhelatëve të UDB-së e ngritë figurën e tij në shkallën e një heroi të përmasave të respektume të popullit. Rënia e tij, shërbeu si një flakadan, si një kushttrim pune e hovi më guximshëm e më të vendosur për të vazhduar ma tutje për çumjen në fund të amanetit të tij edhe të krejt dëshmorëve të atdheut.

Personalisht dhe me ata shokë me të cilët unë kom punu mund të na ketë ngelë hatri, mu po, pse edhe unë nuk e mora najqysh naj fishek edhe mos me konë dëshmitar hiç edhe i kësaj që po foli. Po, as asaj nuk i jemi largu najherë, nuk i kemi ikë najherë në asnjë lloj rrethane. Në anën tjetër osht' mirë që jemi, se s'paku dëshmojmë, e kemi mundësinë me dëshmu për ata që nuk flasin ma. Po ata janë në përjetësi, ata janë fanarë të këtij populli dhe ngelën fanarë drite për brezat që vijnë pas nesh e gjithmonë sa të ketë shqiptarë e sa të ketë Shqipni.

Anita Susuri: Zotni Naser, doni me vazhdu me na tregu për periudhën e pas luftës? Keni marrë pjesë në disa demonstrata që janë bo?

Naser Kuka: Po. Të pakënaqur me gjendjen që u kriju në Mitrovicë, përkatësisht me ndarjen e Mitrovicës, me burgosje që fillunë meniherë pas luftës së ushtarëve, me ata që ishin arrestu në kohën e Serbisë e që vazhdonin të mbaheshin ende në burgje, ne u detyrum që në forma të ndryshme, në

kuadër të Shoqatës së të Burgosurve Politikë në komunën e Kaçanikut, me organizu protesta të herë pas hershme, “Lironi të burgosurit! Mitrovica osht’ Kosovë!” Dhe në 2001 edhe me demonstrata në përkrahje të luftës së drejtë të shqiptarëve në Maqedoni, përkatësisht Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Ndjehem mirë që edhe në fushëbetejen e luftës së kësaj ushtrie në trojet shqiptare në Maqedoni, kam ba atë që kam mund ta bëj dhe kam realizu pakursyeshëm përkrahje dhe mbështetje. Sidomos në fillimin e saj ku jom angazhu bashkë me të tjerë shokë për sigurimin e logjistikës ushtarake të armatimit, ushqimeve, municionit dhe, edhe mjeteve financiare të domosdoshme për mbajtje në kambë të ni ushtrie që vet formohet në mënyrë vullnetare, pa mbështetje, pa përkrahje nga asnja.

Domethonë, çdo gja që ndodhë sikurse te ne, te Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka ndodhë në baza vullnetare edhe pjesëmarrja në luftë është vullnetare edhe mobilizimi është në baza vullnetare edhe përkrahja është në baza vullnetare. Atje ka ndodhë pothuajse kësisoji, vetëm se atje ka qenë ni shtresë, ish ushtarak që kanë shërby në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kanë pasë përvojë lufte dhe që e kanë njoftë artin ushtarak. Pastaj, ne kemi kry detyrat tona në rrethanat edhe në mundësitë që kemi pasë. Po ndjehemi mirë që kemi arritë me dhanë edhe aty ni kontribut, sikurse edhe në UÇPMP.

Do ta thosha për përmbyllje në këtë rast, sado që kam thanë në këtë lloj interviste, boll e kanë bo veç ata që, ata që jetën e tyre e kanë vu në shërbim të themeleve të shtetit të lirisë edhe të pavarësisë të Kosovës. Domethonë, vetëm dëshmorët e këtij vendi, ata e kanë bo boll, të gjallët kurrë s’e bajnë boll për atdheun sado që të bësh. Ne jemi përpjekë, brezi ynë është përpjekë me ba, me dhanë pakursyeshëm. Nëse kemi arritë me kry detyrën tonë ndaj atdheut e ndaj popullit, këtij populli tonë, do të ndjehemi mirë.

Anita Susuri: Zoti Naser, faleminderit shumë edhe për kontributin e juj edhe për intervistën.

Naser Kuka: Faleminderit juve! Ishalla e keni shëndetin, ishalla zbardhni sa ma shumë gjëra që ende nuk i ka pa drita e diellit me sy.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!